

QEMAL HAXHIHASANI

TË FOLMET SHOQNORE

Në truëllin e shqipes, krahas gjuhës së përbashkët dhe dialekteve territoriale, rrojnë edhe një tog të folmesh e mënyrash të veçanta komunikimi, të cilat njihen me emna të ndryshëm simbas krahinave, rretheve shoqnore, grupeve profesioniste, që i kanë përdorë. Të tilla janë p.sh. **purishtja** — e folmja e zanatit të muratorve të Oparit (Korçë); **dogançja** — e folmja e kallajxhijve të Brezhdanit, Limarit, Malëshovës dhe e xharejve të Bualit; **lovidharçja** — e sharraxhijve të Kaludhit, Kanikolit, Pëllumbasit (Përmet); **dalipbeçja** — e belaxhijve të Shëngjergjit, Shëmrisë, Shëngjinit (Tiranë), etj. Këto të folme, të ngritura në kushte të veçanta jetësore, mbi strukturën gramatikore dhe brumin leksikor të gjuhës amtare, kanë tërhekë, me karakterin e tyre të mbyllun, me leksikun dhe me mjetet që janë shfrytëzue në ndërtimin e tyre, vëmendjen e studjuesve tanë, të cilët, midis së tjerash, kanë çfaqë edhe ndonji mendim për probleme të këtyne të folmeve¹⁾. Megjithëkëtë mund të thomi se në letërsinë tonë gjuhësore studime analitike për këto të folme deri sot nuk ka pasë²⁾. Linguistë të huej që janë marrë me studimin e të folmeve të zejtarëve të popujve të tjerë të Ballkanit (të opingarve të Përlepit, rrobaqepsëve të Lazaropoljes, muratorve të Kovaçevicës, etj.), kanë vu në dukje kontributin e shqipes në sajimin e këtyne të fol-

1) Mendime për dialektet tona shoqnore (gjuhët speciale, të folmet konvencionale, etj.) janë çfaqë nga prof. E. Çabej në kursin e gjuhësisë, zhvillue më 1948 pranë Institutit Pedagogjik të Tiranës; nga Prof. M. Domi, Sh. Demiraj, J. Gjinari e S. Floqi, në kurset e zhvillueme ma vonë në Fakultetin Histori-Filologji.

2) Prof. E. Çabej ka pasë ndërmarrë prej kohësh (1942) një studim rreth elementeve të shqipes, që kanë hy në të folmet e zejtarëve të Greqisë Veriore, por, me sa jemi informue, kjo punë ka mbetë ende e papërfundueme. Gjithashtu duhet mbajtë parasysh se P. Daka ka botue disa glosa nga çorkishtja — e folmja e muratorëve të Panaritit (Korçë) në artikullin e tij **Ekspedita e parë leksikologjike** «Zëri i Rinisë», 18 tetor 1958; M. Habili ka lexue një punim për dogançen e Malëshovës në një sesion shkencor të organizueme me studentët e Fakultetit Histori-Filologji më 1960-61. Një numër fjalësh nga purishtja ka qenë regjistrueme më 1952 nga M. Furxhi dhe më 1954 nga A. Gjergji.

meve³⁾. Nji problem të njajhtë — elementet shqipe në të folmet konvencionale të Sllavëve të Jugut — ka trajtue me kompetencë dhe me një vështrim të gjanë përgjithësues Prof. K. Taljavini në kapitullin e fundit të studimit të tij **Të folmet shqipe të tipit të gegënishtes lindore**⁴⁾.

Të folmet konvencionale kanë tërheqë prej kohësh vëmendjen e lingvistëve dhe janë bamë objekt studimesh në letërsinë gjuhësore të popujve të tjerë. Nji traditë të herëshme kanë studimet rreth argove franceze, në të cilat janë rrahë probleme të origjinës, vjetërsisë, mënyrës së ndërtimit të të folmeve të vendeve të ndryshme të Francës. Studime të shumta ka gjithashtu për xhergot italiane, për të folmet e mshehta gjermane, ruse, çeke, spanjolle, portugeze, angleze. Midis të folmeve konvencionale të Ballkanit, janë studjue ma tepër të folmet e zejtarëve Maqedonisë, Bullgarisë, Rumanisë, Greqisë Veriore, Bosnjes, Serbisë. Vëmendja e studjuesve në këto studime asht përqëndrue ma shumë në paraqitjen e fjalorit, në analiza etimologjike, në vështrimin e origjinës, të përhapjes dhe sferës së përdorimit të këtyne të folmeve. Veç problemeve të kësaj natyre janë trajtue edhe probleme me karakter teorik, siç asht përcaktimi dhe grupimi i tyre si kategori gjuhësore, problemi i monogjenezës e i poligjenezës etj.

Në letërsinë e përgjithëshme gjuhësore, krahas termave të veçanta që janë krijuë në ketë ose atë gjuhë⁵⁾, përdoren, për dallimin e këtyne të folmeve, emna të ndryshëm. Disa studjues i kanë quajtë **gjuhë speciale, gjuhë artificiale, gjuhë konvencionale**, disa të tjerë **gjuhë zanati, gjuhë të mshehta, gjuhë lypsish, vjedhësish**, disa thjesht **argo** a **xhergo**. Të tilla terma e kanë origjinën te mënyra e të kuptuemit të këtyne të folmeve, te përcaktimi i specifikës së tyre si kategori gjuhësore. Sado i saktë që të jetë përcaktimi i ndonji tipari themelor që epet me këta ter-

3) Vatroslav Jagić. **Die Geheimsprachen bei den Slaven** në «Sitzungsberichte der phil. Hist. Klasse der hais. Akad. der Wissenschaft» CXXXIII. Wien 1895 f. 25 (shënon elementet shqipe që gjenden në argonë e muratorve bosnjakë, e

cila njihet me emnin Osacani). I. D. Sismanov. **Бѣлѣзхки за бѣлѣгарскитѣ тајни езичи и пословеѣки говори** në «Сbornik za narodni umotvorenija, nauka i knizhina» XII (1895) II f. 37 e vij. (Ka dhanë rreth 100 fjalë të argosë së muratorve dibranë, që flasin slavisht. 20 prej tyre Shishmanovi i ka gjetë me origjinë nga shqipja); N. Arnaudov. **Taenij terzijski eziki** në «Sbornik narod umotvor. XXII-XXII» (1906-1907) f. 2 (Ka studjue gjuhën konvencionale të terzive të Lazaropoljes); M. Tzepenkov. **Uslloven botusharski ezik, v Prillep** në «Sbornik nar. Umotv. nauka i kn.» VIII (1892) II, 284-287; A.P. Stoilov. **Bëlgarski aromënski i albanski folklor**

në «Sbornik za narod. U umotvor», XXXVI (1926) f. 164-173; S. Trojanović; «**Prihlozi tajnini jezicima** në Juzhnosll. filolog V (1925-26) f. 222-226.

4) C. Tagliavini, **Le parlate albanesi di tipo ghego orientale** në «Le terre albanesi redente» I Kossovo. Roma 1943, f. 73-82.

5) Në gjuhën frange këto të folme thirren **argo** (argot), term që asht përdorë edhe në ndonji gjuhë tjetër; në italisht **furbesko** (furbesco), nga fjala furbo: dinak dhe xhergo (gergo); në gjermanisht **rotwelsch** (rotwelsch) nga welsche: e kuqe — fjalë popullore përcmuese, që përdoret për të tregue gjuhët romane, ose: **geheimshprahe**, (geheimsprache): gjuhë e mshehtë; në spanjollget **germania** nga e folmja dhe korporata e vëllezënve **germanos**, **hermanos**: në anglisht **kent** (cant); në portugjisht **kalao** (calão); në rusisht **uslovni jezik**: gjuhë konvencionale; në serbisht **taini jezik**; gjuhë e mshehtë; në rumanisht: **këreitorilor** (cărăitorilor): gjuhë e vjedhësve, etj.

ma, duhet shënue se ata nuk e mbërthejnë si duhet gjithë kuptimin, nuk apin në mënyrë të plotë nocionin që duen të përfaqësojnë; si rrjedhim, asnjëni prej tyre nuk ka mundë të përgjithësohet dhe të zają vend në një formë të qëndrueshme në fushën e këtyne studimeve. Së pari mendohet se vetë fjala **gjuhë** asht e papërshtatëshme, mbasi këto të folme nuk kanë një sistem gramatikor — me një ndërtim morfologjik e sintaktik të veçantë, nuk kanë një pasuni leksikore të pavarun. Ato aftësinë komunikuese e fitojnë nga një numër i kufizuem fjalësh nga një fjalor i posaçëm, që i mer elementet e tij nga gjuha amtare, ose nga gjuhë të tjera që jetojnë gjeografikisht a historikisht afër saj. Ato nuk mund të quhen gjuhë **artificiale** e gjuhë **konvencionale**, sepse nuk janë fryt i një përpunimi individual, nuk janë sajue në mënyrë artificiale a konvencionale nga tryeza e studiuesve, si ndodh me esperanton, volapiikun, idon etj. Termat **gjuhë zanati**, **të folme të mshehta**, **lypsish**, etj. janë gjithashtu të ngushta për të përfshimë plotësisht nocionin përkatës. Në kohët e fundit, këto të folme po vështrohen në kuadrin dialektologjik, si degëzime të veçanta të gjuhës së folun, dhe, për t'i dallue nga dialektet territoriale, po emnohen në bazë të specifikës së tyre me termin **dialekte shoqnore**⁶⁾.

Pikpamje të ndryshme janë çfaqë edhe lidhun me origjinën e tyre. Tue u nisë nga elemente leksikale të përbashkëta që vihen re në disa të folme të Europës (fjalë provençale, greke, hebraike, arabe) asht ngritë për dialektet shoqnore të Europës Jugore problemi i monogjenezës — i krijimit të këtyne të folmeve nga një bazë e përbashkët. Studjues të ndryshëm kanë marrë anën e kësaj teze, ⁷⁾ por ka edhe të tjerë që mbrojnë një tezë të kundërt — ate të lindjes dhe zhvillimit të këtyne të folmeve në një mënyrë të pavarun prej njana tjetrës⁸⁾. Një problem i tillë mund të shtrohet aqë ma tepër me interes për prejardhjen e të folmeve shoqnore, që kanë si bazë të përbashkët të njejtën gjuhë amtare — në rastin tonë, siç do të trajtohet ma tutje — për shpjegimin e afrive që paraqesin midis tyre, p.sh. dogançja e lovidharçja, purishtja e çorkishtja, dogançja e purishtja, etj.

Trajtimi i problemeve që lidhen me dialektet tona shoqnore njohja e llojeve dhe e zonave të përhapjes së këtyne të folmeve, e procesit të lindjes dhe zhvillimit të tyre, studimi i pasunisë leksikore, i ndërtimit të elementeve të fjalorit, i mënyrës së ndërlihdjes së këtyne elementeve, për t'u bamë një mjet shprehje dhe komunikimi midis njerëzve, nuk asht pa interes për dialektologjinë dhe gjuhën tonë në përgjithësi. Këto forma të veçanta të zhvillimit të gjuhës, megjithëqë i përkasin një periudhe të kapërcyeme dhe përbajnë fenomene që e kanë humbë funksionin e vet shoqnor në kushtet e pushtetit tonë popullor, na apin një material të vlefshëm për vëzhgime dhe analiza të ndryshme gjuhësore e historike. Baza e sistemit leksikor të këtyne të folmeve, siç u tha, asht gjuha amtare; lakimi i emnave e i mbiemnave, zgjedhimi i foljeve, ndërlihdja e elementeve të fjalorit, bahet simbas rregullave dhe ligjeve të kësaj

6. V. Zhirmunskij, *Gjuha nacionale dhe dialektet shoqërore*, 1956, f. 150; I. Stoikov, *Dialektet shoqnore* (sipas materialeve të gjuhës bullgare) botue në «Vaprosi jazikoznanja». Moskë, 1957 — Nr. 1, f. 78-84.

7) Mbrojtësi ma i njohun i tezës së një burimi të përbashkët të këtyne të folmeve asht gjuhëtari englez G. Borrow.

8) G.I. Ascoli, *Studi critici* II — 106; Biondelli, *Studi sulle lingue furbesche*, Milano, 1846.

gjuhe. Probleme të veçanta, si rruajtja e kuptimeve të herëshme në arkaizma, mënyra e kombinimeve morfologjike e semantike, formimi i elementeve leksikore, asimilimi i elementëve të hueja, produktiviteti i mbrapashtesave, etj. janë probleme me interes, jo vetëm për njohjen e këtyne të folmeve, por edhe për studimin e zhvillimit të gjuhës në përgjithësi dhe për njohjen e aftësisë dinamike të saj. Studimi i ndikimeve nga gjuhët fqijë, analiza etimologjike e elementeve të prejardhuna nga këto gjuhë, paraqit një interes ballkanik.

Dialektet tona shoqnore janë krijuar dhe përdorë kryesisht nga zejtarë shtetit, gjatë ushtrimit të zejës së tyre jashtë vendlindjes. Ato hedhin dritë mbi kushtet e jetesës dhe vështirësitë që hashin këta profesionistë ambulantë në punën e tyre të përditëshme. Nga një anë tjetër ato pasqyrojnë mbeturina të organizimit dhe të formave të mbylluna që ka pasë zejtaria në kohën e marrëdhënieve ekonomike të sistemit feudal, forma që u rrujtën deri vonë edhe në kapitalizëm, elemente këta që mund të shfrytëzohen me interes edhe në kuadrin e studimeve historike.

Qëllimi i ynë asht të apim një vështrim të përgjithshëm të këtyne problemeve që lidhen me dialektet tona shoqnore, të përshkruajmë format dhe llojet e këtyne të folmeve, zonat e përhapjes së tyre, rrethet shoqnore që i kanë përdorë, kushtet historike që kanë favorizuar lindjen dhe përhapjen e tyre. Këto probleme do të trajtohen në bazë materiale të mbledhuna në terren, nëpër ekspeditat kërkimore që janë bamë në krahina të ndryshme të atdheut (nga viti 1949 deri më 1962).

Kontakti i parë me këto të folme u muer në një ekspeditë folklorike të zonave verilindore të Tiranës në shtator 1949. Midis thesarit të pashterun të traditave dhe të dijes popullore, ne na tërheqën vëmendjen atëherë në këte ekspeditë edhe elemente të gjuhës së përdorun nga belaxhijtë e Shëngjergjit, Shënmërisë dhe Shëngjinit, — të dalipbeçes, siç quhesh nga banorët e kësaj krahine kjo e folme. Ç'prej asaj kohe u banë kërkimeve sistematike rreth këtyne të folmeve edhe në vise të tjera të Shqipnisë. Kështu, u mblodhën të dhana për dogançen e lovidharçen në ekspeditat e viteve 1950, 53, 54, 57, në katundet e Përmetit: Këlcyrë, Brezhdan, Malëshovë, Limar, Leskaj, Bual, Grabovë, Kaludh, Kanikol, Strëmbec, Pëllumbas; në katundet e Leskovikut: Podë, Shalës; në Vërtop dhe në Malëshovë të Beratit; për purishten: në ekspeditat e viteve 1954-55 në katundet Gjergjevicë, Marjan, Gjonbabas, Xerje, Trebickë, Orgocë dhe në katundin Selvijas të Sulovës, ku pata rastin të njihem me disa punëtorë stinorë oparakë dhe të shoh përdorimin praktik të kësaj së folmeje. Për të folmet zogjënishte të studentëve etj. janë mblodhë materiale në Vlonë, Elbasan, Pogradec, Lezhë, Shkodër; ndërsa për të folmet e zanatit të minoriteteve — për alifiatikon e sopikçen (të minoritetit grek) dhe për të folmen e muratorve të Gollobordës janë shfrytëzue informatorë të rastit që janë hasë në ekspeditat e ndryshme në Durrës, Gjinkastër, Dibër ose nga puntorë që jetojnë në kryeqytet.

Të folmet shoqnore kanë një specifikë të vetën, që i dallon nga gjuha e përbashkët ose nga dialektet e saja territoriale. Ndërsa gjuha e përbashkët ka një funksion shoqnor, këto të folme shërbejnë si mjet komunikimi vetëm në disa rrethana të caktueme të jetës, ato lindin si fenomene individuale dhe përgjithësohen në një grup të kufizuem njerëzish me interesa të përbashkëta profesionale. Të folme të tilla zhvillohen në ambiente të izolueme, ku praktikohet jeta në bashkësi, në rrethe studentësh, sekte fetare, grupe vjedhësish, lypësish, bakëqijësh. Sipas gjuhëta-

rit italian. G.I. Ascoli, ato janë një farë krijimi lajthitës i inteligjencës njerëzore për t'u rrujtë të tjerëve; simbas gjuhëtarit freng A. Dauzat — një element kohezioni i grupeve të mbyllura, një reaksion kundër profanëve, kundër agjentëve të jashtëm që kërkojnë të çthurin këto grupe, një organ mbrojtës i tyre. Dikur, njerëzve me qëllime shoqnore të errëta, vjedhësve, mashtruesve, bakëqijëve, u asht dashtë të përdorin mënyra të veçanta kon unikimi, pa zbulue qëllimet e veta në sy të tjerëve. Zejtaret shtetës në një vijë të kundërt — për t'u mbrojtë nga vështirësi e rreziqe, që u delshin përpara, për sigurimin e punës, banesës, ushqimit etj. kanë qenë detyrue të përdorin mjete komunikimi të pakuptueshme nga ambienti që i rrethonte. Kallajxhijtë e Përmetit e ushtroreshin mjeshtërinë e vet deri në krahinat ma veriore të atdheut. Në shtegtimin e tyre nëpër vise e rrugë të panjohuna, në kontraktimin e punës dhe të shpërblimit, në kapërximin e rreziqeve që u kërcenojshin ndonjherë edhe jetën, kishin nevojë për një këshillim dhe vendim të përbashkët me shokët e grupit. Muratorët oparakë përhapeshin jo vetëm në zonat e Jugut, nga Shkumbini deri thellë në Çamëri, por edhe jashtë kufijve të Shqipnisë. Kryemjeshtri, në pajtimin e punës, në marrjen përsipër të ndërtimit të shtëpive, në pranimin e kërkesave që i shtroheshin nga punëdhanësi, rreth llojit dhe madhësisë së ndërtesës, sasisë dhe shpërblimit etj. duhesh të këshillohesh me shokët e vet. Edhe gjatë procesit të punës, pjestarvet të grupit u duhesh të merrshin vesh me njëri tjetrin për cilësinë e punimeve dhe nevojat e tjera të jetës në një gjuhë që të mos kuptohesh nga punëdhanësi. Të njejtat nevoja delshin për belaxhijtë e Tomadhesë, kur punojshin në krahinat e Jugut ose edhe në Greqi, për xharejtë e Bualit, kur do të përcaktojshin diagnozën e sëmundjes dhe do t'i rekomandojshin përdorimin e barnave pacientit, për sharraxhijtë e Përmetit, kur endeshin në grup nëpër zonat pyjore të Shqipnisë së mesme dhe të Veriut, etj. Nevojave që lindshin në kushtet e ushtrimit të zejës, u shtroheshin vështirësi të tjera, që krijoheshin nga rrethana administrative shtetnore. Zejtareve shtetës u duhesh të përballojshin vështirësitë e kapërximit të kufinit shtetnor, kur delshin për punë jashtë atdheut ose kur ktheheshin në vendlindje tue sjellë ndonji objekt, që ndalohej nga kontrolli doganor. Belaxhijtë e Shëngjergjit në një kohë të caktueme të vitit merrshin vesh me anë zjarresh me sipërmarrësit grekë që afroheshin me barka natën në bregdetin shqiptar. Kur ktheheshin prej këtij lloj kurbeti ata sillshin, në kohën e Turqisë, zakonisht ndonji armë krahu, objekte bakëri etj.

Zejtarët shtetës ishin në mbikqyrje të vazhdueshme të organeve qeveritare. Nën këte psikozë ndjekje, vëzhgimi, kontrolli, kanë lindë lloj lloj fjalësh me ngjyrë përcmuese, për të tregue policët, xhandarët etj.: **Shufërzitë, shkopësit, tortëzest, haxhikullakët, xhandot,** etj. Banorët e Polisit-të një katundi në lindje të Elbasanit, që merrshin me përgatitjen e landëve të ndërtimit — për t'i shpëtue kontrollit të rojeve pyjore, kur zbritshin në qytet, përdorshin shprehje e terma të pakuptueshme, të cilat po të vazhdojshin rrethanat që i lindën, mund të përfundojshin në një të folme të mëshehtë të veçantë.

Tendenat për diferencimin e të folmeve shoqnore janë inherente në gjuhën e përbashkët. Njeriu, në komunikimin e tij me të tjerët, e ndien si një nevojë të natyrëshme t'i api bisedës një ngjyrë humoristike, ta gjallërojë të folmen me figura, krahasime, epitete e sinonime. Pikërisht këto mjete dhe ngjyra stilistike të bisedës krijojnë mundësinë për

një farë diferencimi të gjuhës, diferencim, që, nën ndikimin e faktorëve të veçantë, arrin të thellohet dhe të përfundojë deri në një mjet marrëveshje dhe komunikimi direkt midis njerëzve. Ka koncepte që shprehën në gjuhën familjare me një numër trajtash sinonimike. P.sh. për të tregue një njeri që ka ngranë shumë dhe asht ngopë, thomi: **u zhap, u ngop, u dynd, u fâ, u âj, u rras, u llâ, u shemb, u ba tinë, u ba calik, u mbush deri në fyt etj.**; për një që vjedh: **e thithi, e qëroi, e turqepsi, e mshiu, e për lau, e grepi, e krydhi, e teri, e thau, e klepsi, e trosi, e xhveshi, e bani fushë, e bani vardë, e bani rub, e nxuer në diell etj.**; për fjalën kokë: **kungull (s'të mbushet kungulli ty), tuqe (more, vere gishtin në tuqet, se çinia vjen rrotull — Përmet), kukuliqe (mblidhe kukuliqen — po aty) kapëll (neshti iu mush kaplla — Tiranë), gllavë, rradake, kaptinë, tutkë (ja paska prerë tutka dencës të më kërkojë mua çupën — Korçë) kaplloqe, karroqe, barokë, rrabë.** Ka raste kur fjalët përdoren me kuptime të ndryshme figurative e metaforike. P.sh. **Sa vrave me këtë artikull a libër (sa more); e martove biçikletën (e shite); a lu' neq rrumllake (ambëlsinë) sonte; ka vajtur të marë ceret (paratë) (Korçë); (cinga (pare) të kesh se çdo gjo gje' n'pazar (Tiranë); atje valo'vupja (dajaku) (Tiranë).** Të frytëshme janë për diferencimin e të folmeve shoqërore edhe bisedat alegorike. Malsorët e Dibrës janë të njoftun për përdorimin e këtyne lloj bisedave. Ata i veshin kaqë mirë me velin e alegorisë mendimet e tyre, merren vesh me njani tjetrin me kaqë mjeshtëri me anë aluzionesh, sa një njeri i huej nuk mund të kuptojë në shumë raste kuvendet që bajnë⁹⁾.

Këto shembulla i përkasin truellit stilistik, por njerëzve në jetë i çfaqen shpeshherë edhe rrethana direkte që i shtrëngojnë të komunikojnë njani me tjetrin në mënyrë të heshtun me fjalë ose me mjete të tjera të pakuptueshme nga rrethi. Kështu përdoren shenja me duer, me buzë, me krye etj. për të komunikue një mendim, një dëshirë ose një nevojë. Muzikantët kur duen të tregojnë që një njeri nuk ka vesh, kapin cepin e palltos në grusht dhe e ngrejnë në shembëllin e veshit të gomarit. Banorët e qytetit të Tiranës përdorin fjalë nga aromunishtja si:

9) a) Po apim disa fragmente bisedash të tilla: Bajraktari i Muhrit D.H., për t'i dhanë randësi katundit të vet, mundohesh të tërhiqte aty komunen dhe postkomandën që ndodheshin në një katund pranë (në Katundin e ri). Ai tërheq ma parë komunen me shpresë së largimi i saj nuk do të binte edhe kaqë në sy të katundarëve. Por një nga pleqt e katundit të Ri A.L. shkon dhe i ankohet bajraktarit: **Hajredin-a, kemi pasë në shpajn tonë një lopë me vajç (viç). Nuk di se si ndodhi dhe lopën erdhën e ma morën. Çtahe vajçi po na nxer me toj gërkou t'amen. Shka lypet me ba ç'i t'rahatohe mi? Bajraktari, që e kish kuptue mirë se ku rrihte plaku, i përgjigjet: Kouaj munet me u rregullou kjo punë: duhet bashkou lopa me vajçin; o toj kome lopën në shpaj, o toj çou vajçin te e ama; po me qene se vajçi asht ma i vogël, i bie këtëj me shkou te e ama. Plaku e kupton se mbas komunes do të largonesh cane postkomana, prandaj nuk e zgjati ma, veç u ngrit tue thanë: Dilem do t'merret edhe vajçi allahile te merret sa ma parë e t'i epet fun ksaj pune.**

b) Njeni i ep kutinë e duhanit shokut për të dredhë një cigar, po në vend që t'ia kthejë kutinë, ai harron dhe e fut në xhepin e vet. I zoti i kutisë i drejtohet një personi të tretë që ndodhej aty: **Komshiu më mori hua kalin për me bjue, maroi punë dhe në vend ç'i të ma sjelli kafshën në shpej, e çoi në ahur të vet. E kupton menjherë i interesuemi dhe qit e i ep kutinë.**

c) **A. Si u datë, or taj me be be be apo me me, me, me? B. As me be be be, as me me me me, po edhe hi hi hi — ja na met atje (tue dashtë me tregue se nuk kishin mundë të marrin as dele as dhi, po edhe kali u kish mbetë andej).**

kidî usha (mbylle derën). **nurr** (hesht), **ari** (ka)! **umllu kapllu** (mbushe kokën), **nare mini kaplli** ose **nare tini kaplli**, **xhimiti kaplli** (jam pa mend, je pa mend, gjysmë kokë). Në ambientin e rretheve tona artistike ndihen fjalë arxhishte si **aspi** (mos e zgjat), **mos panell** (mos llap.) Midis ushtarve janë krijuar terma e shprehje si: po presim **Dautin** kohën e lirimt — dorëzimit (d) armëve (a) ushtarëve (u) të ri (t). Gjurma e mbulimit të dëshirave, ndjenjave etj. me fjalë të huajtuna nga gjuhë të tjera ose të krijueme nga fjalori i gjuhës, gjenden edhe në krijimet popullore. Në një kangë kolendrash të krahinës së Pogradecit shihen vargjet: **Ciu ciu, vak, vak/ dënj o babo një kullak/ kullaku e shënmërisë,/ çel derën e perëndisë**. Vargu i dytë asht thanë aromunisht: epna gjyshe një kullak, për të mos ranë në sy kërkesa e dhuratave që bahet nga të vegjëlit. Personazhet e një përralle të mbledhun në Elbasan, për të mos u kuptue rga ambientin, përdorin fjalë të tilla: **po vlon llobja** (vorbja)... **hiqi llaçën** (kapakun)... **lumthi unë që s'piptha** (që s'fola). Në një përrallë të Myzeqesë macja thirret **grindje**, zjarri gaz, shtëpia — **çlodhje**, uji — **lirëje**, fronti — **kollokumbe**. **Prift, zjarri, grindja ngriti gazin, gazi çlodhjen dhe, në mos dërgofsh lirjen, të humbi çlodhja bashkë me kollokumbet** 10). Në një përrallë tjetër të Lushnjës personazhet e një fabule flasin: **Të bëftë mirë, moj babedhebo** (dhelper)! **Të falemnderit babeloni** (ujk) 11).

Në qoftë se mjetet dhe ngjyrat stilistike të bisedës (humori, alegoria, etj.), përbajnë pikënisjen a prirjen për diferencimin e gjuhës, elemente të tilla komunikimi që përfaqësojnë përpjekjet për t'u marrë vesht me njani tjetrin pa u kuptue nga ambienti, formojnë premisat e krijimit të të folmeve shoqnore. Faktor themelor në lindjen dhe zhvillimin e këtyne të folmeve mbetet gjithmonë nevoja e komunikimit të njerëzve në një mënyrë të mshhtë, të pakuptueshme nga rrethi. Shkaqet që kanë kushtëzue një nevojë të tillë ndryshojnë simbas qëllimeve dhe grupeve shoqnore ku janë përdorë këto të folme. Në rrethet intime familiare ato lindin mbi një bazë humoristike, nga dëshira për ndonji surprizë me njerzit e familjes — për të gjetë rrugëdalje, kur ndodhesh përballë ndonjë vizite miqësore të papritun etj., në rrethet e studentëve për të shpëtue nga vështirësitë e përgjigjes ndër mësim, për të ba shaka me cenet e ndonji pedagogu ose për ndonji aventurë gazmore të jetës studenteske; në rrethet ushtarake, për të thye monotoninë e disiplinës së ushtrisë etj. Por në grupet profesioniste, që rrojnë në kurbet stinor, sikurse asht thanë, nevoja e komunikimit në një gjuhë të pakuptueshme nga ambienti lind dhe kushtëzohet kryesisht nga shkaqet jetësore. Këto rrethana çfaqen që me daljen nga vendlindja — në udhëtimin nëpër vende të panjohuna, me ushtrimin e zanatit e deri në kthimin në familje. Populli i quen të folmet që përdoren në të tilla rrethana gjuhë halli, gjuhë nevojë, gjuhë zanati. Dhe me të vërtetë ato përdoren prej zejtarve shetitës nga nevojat që u dalin përpara në kushtet e pasigurisë së vazhdueshme të jetesës. Në një vend të huej e të panjohtun, ku njeriu nuk ka të sigurtë as banesën, as ushqimin, as punën, madje as jetën, asht e natyrshme të rrojë gjithmonë në preokupacion për kapërcimin e këtyne vështirësive. Për të formue një ide rreth karakterit të bisedave që shtjellohen midis zejtarve ambulantë, po apim një shembull nga bisedat e zakonëshme të kallajxhijve të Brezhdanit në dogançe: **Ngrecuam në**

10) Arkivi i Institutit të Folklorit. Fondi i Min. së Arësim. Dos. 27, f. 1.

11) Po aty, Dos. 22 — f. 80.

garth (erdhëm në katund). Logos për nonjë ngulës të kolmë (shiko për ndonji konak të mirë). Ja pëlçet, po zogos kol: (Ka, po kërkon shumë). Qapoje, qapoje (zene, zene). Tani fryni dhe legosni për saplla (tani shkoni dhe shikoni për enë). Aniksni trocet kol (Hapni sytë mirë). Sa t'i qërojmë për komatje? (Sa t'i marrim për copë). Zogosni nga një zhapë (kërkoni nga 100 lekë). Shtrungatni sapllat kol dhe fryni në ngulës. (Numroni mirë enët dhe shkoni në konak). Fryj e zogos ca korto për kapuq (Shko e kërko ca bar për gomarin). Zogos edhe shtengëza për forfol (Kërko edhe dru për zjarr).

Siç shihet, këto bisedime kanë të bajnë me nevoja themelore të jetës, prandaj e do puna që mshehtësia e tyne të ruhet me kujdes përpara njerëzve që nuk kanë të njajtat interesa. Zejtaret shetitës tregohen të vëmendshëm për ruejtjen e sekretit të së folmes së tyne, jo vetëm përpara njerëzve të dyshimtë, po edhe përpara atyne me të cilët lidhen me miqësi në zonat ku punojnë (njerëzve që i strehojnë, i marrin në mbrojtje ose u bajnë ndere të ndryshme). «Sado mik ta kesh tjetrin, më thonë të një kallajxhi plak nga Brezhdani, gjuhën e zanatit z'bën t'ja rrëfesh». Mshehtësia, që lidhet me nevoja jetike, asht bamë një nga tiparet themelore të këtyre të folmeve. Prandaj të folmet shoqërore janë quejtë në shumë vende edhe me emnin gjuhë të mshehta (gjerm. **Geheimsprache**; fr. **langues secrètes**; it. **lingue secreta**). Ruejtja e mshehtësisë ka marrë një karakter pothuajse ritual dhe kjo mendësi ka vazhduer deri në ditët e sotme. Në mbledhjen e materialeve të të folmeve tona ne kemi pasë zakonisht mirëkuptim me informatorët. U asht shpjegue qëllimi i mbledhjes e i studimit të tyne dhe ata u janë përgjegjë kërkesave tona. Por ka pasë edhe raste, sidomos në Opar, kur subjektet janë tregue të mbyllun, tue e quejtë nxjerrjen e mshehtësisë së tyne si një shkelje ligjëshmënie kundrejt grupit të zejtarve përkatës. Nuk ka qenë vetëm ndruejtja që tregohet zakonisht kundrejt njerëzve të qytetit, të cilët vijnë e interesohen për doket e kalueme, por ma tepër kujdesi për ruejtjen e një sekretit tradicional, që i ka detyrue ata të mbajnë një qëndrim të tillë. Ne na janë dhanë në disa raste përgjigje të tilla. Këto gjëra nuk tregohen. Dikush: «Nuk e kam përdorur këtë gjuhë»; ndonjë tjetër: «E kam përdorur, por e kam harruar tani». Nji murator nga Gjergjevica mundi të më tregojë disa elementë të purishtes, mbasi u këshillue më parë me udhëheqësin e grupit.

Të folmet e zejës fliten jashtë vendlindjes, në kushtet e procesit të punës dhe të jetës në kurbet, prandaj ato mbeten të panjoftuna prej elementit femnor. E shoqja e muratorit N.K., kur më shihte që regjistroje shënime për purishten nga bashkëshorti i saj, tha me çudi: «U bënë kaqë vjet që rroj me këtë burrë dhe as e kam ditur, as e kam dëgjuar të flasi një gjuhë të tillë».

Nji kujdes i veçantë për ruejtjen e mshehtësisë së tyne tregohet në ambientet ku praktikoheshin. Saherë që ndodhte të merrej vesht kuptimi i ndonji fjale, ajo zavendësohej me një fjalë të re. Kështu veprohej jo vetëm kundrejt profanëve, po edhe midis grupeve të zejtarëve të ndryshëm që flitshin të njëjtën gjuhë konvencionale p.sh. kallajxhive, xharejve, sharraxhijve të Përmetit; belaxhijve të Shëmrisë dhe atyne të Shëngjergjit. Disa sharraxhij nga Kaludhi më thonë: «Mëm' e gjuhës sonë (lovidharçes) është Malëshova. Ne vjedhur e kemi nga ata. Kur panë ata se po ja marrëm, i kthyen disa fjalë» Shëmria për fjalët dru, fasule përdor në dalipbeqen: mjetën, met' hysë; Shëngjergji: vishë, xhaflobë.

Këndeje e ka origjinën edhe paqëndrueshmëria dhe lëvizshmëria semantike e fjalorit të të folmeve shoqnore. Kjo veti e tyre përforcohet në mënyrë të veçantë në kushtet e transmetimit gojor. Këto të folme përhapen dhe shtegëtojnë vetëm nëpërmjet të rrugës orale, gojë më gojë. Leksiku e rregullat e zhvillimit dhe të përdorimit të tij nuk kanë asnjë bazë të shkrueme. Ato u mësohen të rijve gjatë procesit të punës. Diemt që shkojshin mbas prindërve, familiarizoheshin me elementët e para të këtyne të folmeve në punë e sipër. Ata ndigjojshin bisedat e ma të mëdhejve dhe kapshin në fillim kuptimin e fjalëve ma të rëndomta, ma të përdorme — të mjeteve të punës (çekan, sharrë, sqepër etj.), të landëve të ndërtimit (gurë, baltë, gëlqere etj.), të njerëzve që i rrethoshin (kryemjeshtri, i zoti i punës, e shoqja, i biri etj.) dhe kështu dalëngadalë zgjanohesh horizonti i së folmes me zgjanimin e horizontit të zejes e të jetës së tyre. Elementët e përvehtësueme në kushte të tilla (me vesh), natyrisht, nuk mund të ndigjoheshin gjithmonë drejt. Kishte raste kur e njajta fjalë ndryshe ndigjohesh dhe fiksohesh midis një grupi muratorësh që punonte në Myzeqe, ndryshe prej një grupi që punonte në Gjinokastër, etj. Edhe ma e vështirë paraqitet rruajtja e unitetit semantik e leksikor, për të folmet e kallajxhiëve a xharejve të Përmetit, të cilët shpërndaeshin në të katër anët e vendit në grupe të kufizueme (2-3 vetash). Prandaj në leksikun e këtyne të folmeve jetojnë shpesh një tog trajtash dhe kuptimesh për të njajtën fjalë.

Me interes do të ishte të shtrohesh çashtja e vjetërsisë së të folmeve tona shoqnore. A janë këto një fenomen i ri në gjuhën tonë apo i takojnë një periudhë pak a shumë të largët? Ne mjerisht nuk kemi ndonjë njohtim historik mbi ekzistencën e tyre. Aqë ma pak nuk kemi ndonjë element leksikor a tekst të shkruem në këto të folme ashtu siç ndodh p.sh. për argotë frange, italiane, spanjolle, gjermane, angleze, etj. Prandaj në radhë të parë ne duhet t'i drejtohem traditës gojore, strukturës së vetë të folmeve dhe rrethanave të tjera që mund të na ndihmojnë tërthorazi për një farë lokalizimi historik të zhvillimit dhe përdorimit të tyre. E folmja ma e njohtun, ma e përhapun dhe ma e stabilizueme midis të folmeve tona shoqnore asht dogançja e Përmetit. Jo vetëm për këta faktorë të randësishëm, por edhe për shkak të disa rrethanave historike që do të shënojmë ma poshtë, kjo e folme duhet të ketë qenë e folmja shoqnore ma e parme në vendin tonë. Ajo duhet të ketë qenë njohtë të paktën që në çerekun e fundit të shek. XVIII. Në rrethin e Beratit ndodhen dy katunde — Vërtopi dhe Malëshova, që punojnë si zejtarë shtetit (kallajxhi, tavanaxhi, tregëtarë) dhe që njohin dhe e përdorin dogançën. Banorët e këtyne katundeve e kanë origjinën nga Hormova, Malëshova dhe Brezhdani (Përmet). Simbas legjendës, i biri i Çausht Prifit, Gjikhë Hormova, mbas masakrës së të jatit prej njerëzve të Ali Pashës më 1769, kaloi mshehtas në Malëshovë të Përmetit dhe prej këndeje shkoi dhe u ngul në Vërtop të Beratit. Me kohë erdhën e u vendosën në këte lokalitet të ri edhe të tjerë banorë nga katundet Malëshovë e Brezhdan (Përmet), të përkrahun nga sundimtari i atershëm i Beratit, Kurt Pasha, i cili vente kundër Ali Pashë Tepelenës. Nga këta banorë të shpërngulun janë sot katundet Vërtop e Malëshovë të Beratit¹²).

12) Nji stërnip i familjes Gjika në Vërtop, Tasi Jani, ka vdekë më 1916 rreth 60 vjeç. Rrjedhja gjenealogjike e tij, simbas tregimit të pleqve, asht: Tasi ka qenë i biri i Jani Tasit, Jani — i biri i Tasi Gjikhës, Tasi i biri i Gjikhë Hormovës. Gjika — i biri i Çausht Prifit.

Ata ruejtën mjeshtritë që prunë nga vendi i origjinës si edhe të folmen që lidhet me zejen e tyne, dogançen. Që këto duhet t'i përkasin një tradite të sjellun nga vendi i lindjes, dëshmon fakti se asnjë nga katundet rreth e rrotull nuk i ushtron këto zeje, dhe se lidhjet me vendet e origjinës, për shkak të largësisë që i ndan kanë qenë kreu të kufizime mbas shpërnguljes. Me një periudhë të tillë të përdorimit të dogançes, përkujtë dhe të tjera informacione gojore. Një farë Thanasi Todhja nga Malëshova e Përmetit ka pasë ba si dervish shetitës në zona të thella të Veriut, deri në Kosovë, i paraqitur me emnin: Dervish Demiri. Aventurat e Thanasit me dogançen në Dibër, Tetovë, Gostivar, Shkup, Prizren etj. kanë mbetë si proverbiale në Malëshovë, Limar e Leskaj. Thanasi ka jetue tarçur në periudhën e naltpërmendun, rreth fillimit të shekullit të kaluem (Thanasi Todhja ka lanë Llikon, ky Stefanin, Stefani — Viton, i cili asht sot rreth 70 vjeç). Nga këto të dhana mund të thuhet se dogançja në këte periudhë ka qenë njohtë e përdorë gjanësisht.

Për purishten nuk kemi ndonji dëshmi historike të randësishme. Nga gjanësia e fjalorit, qëndrueshmëria e trajtave dhe e kuptimit të fjalëve, përhapja gjeografike, edhe kjo e folme, duhet të ketë gjithashtu një farë tradite. Pleq 80-90 vjeçarë tregojnë se këte të folme e kanë mësue prej prindëve që në moshë të njomë (rreth 10 vjeç). Tue u nisë nga ky fakt mund të pranohesh se edhe purishtja ka qenë e njohtun të paktën që në gjysmën e parë të shekullit të kaluem; ndërsa po të lidhesh me kohën që kanë fillue të ushtrojnë mjeshtërinë e muratorit oparakët, do ta shtyjmë origjinën e saj edhe ma përpara, mbasi gjurma të punës së banorëve të Oparit si muratorë, gjenden që në shekujt XVII-XVIII.

E folmja e belaxhinjve të Shëngjergjit, me trajtën e saj të pastabilizue, me pashkrimjen e termave të prejardhuna nga emnat e përveçëm dhe me fjalorin e saj të kufizuem, dëshmon për një kohë relativisht të re. Në goftë se do të pranojmë si autor fillestar të saj Dalip Bebin — prej të cilit ka marrë edhe emnin dalipbebeçe — ajo nuk duhet të jetë ma e herëshme se sa gjysma e fundit të shekullit të kaluem, mbasi Dalipi ka vdekë para rreth 60 vjetësh.

Të folmet shoqnore që fliten me shndrrimin mekanik të gjuhës amtare, duhet të jenë gjithashtu një tradicion i hershëm, mbasi ato njihen në të gjitha anët e vendit; ndërsa jeta e elementeve të argove studenteske dhe ushtarake lidhet me lindjen e këtyne institucioneve në vendin tonë.

Përsa i përket shpërndamjes gjeografike të së folmeve tona shoqnore, vihet re se ato kanë një zhvillim të veçantë në zona kufitare të atdheut (dogançja, lovidharçja) ose në zona të mbrendëshme që rrojnë në fqinjësi me ndonji ishull pakice kombëtare (purishtja). Të folmet shoqnore përdoren mbrenda territorit të gjuhës së përbashkët. Për t'u ba të pakuftueshme nga bashkëatdhetarët asht e natyrëshme që ato ta pasunojnë fjalorin e tyne, krahas arkaizmave, dhe elementeve të tjera që marrin nga gjuha amtare, me fjalë që huajnë nga gjuhët e popujve fqinj në rastin tonë — p.sh. kryesisht nga greqishtja për dogançen dhe aromunishtja për purishten. E najta gja ndodh edhe për të folmet shoqnore të popujve të tjerë. Shumica e të folmeve të zejtarëve të gjuhës greke, si: **kudharítiká**, gjuha e muratorëve të krahinës të Kuliaradhes, **bukuráika** — e terzive të malit Cumerka, **alifiatiká** — e kallajxhiuje të katundeve Grazhdan, Karroq, Fetidh, **sopiqotçja e sopçja** — e vozgarëve të Sopikut etj janë zhvillue në Epir, ku popullsia greke rron në fqinjë-

si me shqiptarët e aromunët; shumica e të folmeve të zanatit në gjuhët slave si **osacani**, e muratorve të katundit Osatrat të Bosnjes, e folmja e opingarëve të Përlepit, e rrobaqepësve të Lazaropoljes, e shtambarve të Prishtinës, e të verbëve të Manastirit, e muratorve të Kovaceviçës, Bracigovës etj. janë krijuar në Bosnje, Kosovë e Maqedoni, ku gjuha sllave rron në të përpjekun me shqipen, aromunishten, turqishten. Nji e folme shoqnore që lind në zona të brendëshme të nji gjuhe, pra larg kontakteve me gjuhë të tjera, të cilat sjellin nji ndihmë të madhe në pasunimin e fjalorit të tyre, asht e vështirë të arrijë nji pjekuni të plotë. Këte e provon edhe **dalipbeçja** e jonë, e cila, veç arsyeve të tjera, nuk mundi të ngrihet në nji shkallë të mjaftueshme zhvillimi nga mungesa e këtyne kontakteve.

Për t'u vu re nga pikpamja dialektologjike asht edhe rruetja e tipareve specifike të dialektit territorial në dialektet shoqnore. Në trajtat fonetike, në mjetet gramatikore — paradigmata e foljeve, lakimet etj. në mënyrën e formimit të fjalëve, në elementët e fjalorit të të folmeve tona shoqnore — të dogançes, lovidharçes, purishtes, çorkishtes, dalipbeçes, pasqyrohen tiparet e të folmeve krahinore — përkitazi të së folmes së Përmetit, Leskovikut, Oparit, Vakëfeve, Tomadhesë. Këndej kuptohet edhe interesi që paraqet studimi i tyre në fushën e studimeve dialektologjike.

Kapitulli më interesant në studimin e të folmeve shoqnore asht pa dyshim studimi i burimeve, i mjeteve dhe i rrugëve të formimit të fjalorit, i cili përban bazën materiale të aftësisë komunikuese të tyre. Për prirjet dhe mundësitë që ka gjuha e përbashkët në diferencimin semantik të disa elementeve të leksikut, në rrethana që përgatisin terrenin e të folmeve shoqnore, asht ba fjalë në vija të përgjithëshme, ma sipër. Interes të veçantë ka praktika e formimit të fjalëve, studimi i shndërimeve semantike, i rrugëve që ndiqen në krijimin e termave të reja, në përvehtësimin e elementëve të huajtur nga gjuhët e hueja. në tretjen dhe në veshjen e këtyne elementeve me frymën e gjuhës amtare.

Përpjekje të gjithanëshme që pasqyrojnë, mënjane inisiativat individuale, më tjetrën forcën krijuese dhe harmonizuese të kolektivit, bahen për sajimin e elementëve të këtij sistemi leksikor të veçantë. Rrugët që ndiqen në krijimin e fjalorit të të folmeve tona, ashtu siç ndodh edhe për të folmet konvencionale të popujve të tjerë, janë dy: 1) shndërimi mekanik i trajtës së jashtëme të fjalorit të gjuhës së përbashkët, 2) krijimi i nji sistemi leksikor me aftësi shprehëse të pavarun.

Përsa i përket rrugës së parë, fjalët e gjuhës së përbashkët nuk pësojnë asnji ndryshim në kuptimin e tyre. Ndryshimi prek vetëm trajtën e tyre të jashtëme. Ato bahen të pakuptueshme nga të tjerët me shndërimin e formës, shkurtimin e fjalës (**Bero, Këlco, pazo, çilo: Berat, Këlcyrë, pazar, çilimi**), zgjatjen me anë të nji a ma shumë rrokjeve argotike (**a-fa i-fi dja-fa-li-fi po-fo të-fë shë-fë-ko-fon ty-fy**; ai djali po të shëkon ty) me çvendosjen e rrokjeve dhe me anagramën (**tos kun maj gatitë-pre: sot nuk jam përgatitë**). Kjo praktikë, që bazohet në fenomene të zakonëshme të gjuhës si në shkurtimin, bisillabizmin, n. etatezën, etj., asht e njoftun edhe në gjuhët e tjera.

Fjalorin e veçantë të të folmeve shoqnore e ushqejnë dy burime të randësishme: fjalori i gjuhës amtare dhe ai i gjuhëve të hueja. Ndërsa

përvehtësimi i elementëve leksikore që merren nga gjuhët e hueja bahet nëpërmjet të një procesi pak a shumë të thjeshtë, në ndërtimin e fjalëve nga brumi i gjuhës së përbashkët ndiqen rrugë dhe ecuni të ndryshme ma të ndërlikueme e ma interesante, të cilat dëshmojnë për një gjallni mendimi, impresionit e shprehje.

Grupet shoqnore, në rrethin e të cilave lindin këto të folme, tue u nisë nga nevoja e mshehtësisë — e moskuptimit të bisedave të tyne nga të tjerët — shfrytëzojnë në një stil të gjanë shndërrimin e kuptimit të fjalëve që merren nga gjuha e përbashkët. Fjalët e marruna për këte qëllim e ruejnë trajtën e tyne, por vishen me një kuptim të ri, i cili nuk asht i kundërt me kuptimin e zakonshëm, por i lidhun ngushtë me te nga ndonji tipar i jashtëm i objektit ose nga ndonji çfaqje tjetër e randësishme e kuptimit të tij. Kështu p.sh. fjalët **bishto cfurk, cipëzos, djegie, fryj, erëz, lëkurje, mbytë, mërxej, mjelje, ngulës, qëroj, rrjedhje, shkelje, shkumbje, thanuqe, vardje**; në dogançe përdoren me kuptimin: qen, pi-run, mbush, qepë, shkoj, hundë, rrobe, gjizë, lâ (pushoj), sisë, konak, marr, çesme, këpucë, kafe, raki, punë; fjalët: **gjatës, gjatje halës, lëpjetë, lidhar, llëpushkë, mbathje, rrethohem, rrotës, shkopës, shkumbës**; në lovidharçe përdoren me kuptimin: tra, rrugë, peshk, gjuhë, brez (muri), letër, opinga, martohem, mulli, rojtar katundi, sapun: fjalët **balash, bishgjatë, djegie, uj, i lagur, lodhem, mjekërs, tres, tymës, i thatë, thar-toj**; në purisht me kuptimin diell, tjegull. uj, vi, hoxhë ose prift ka, duhan, gur, vras; **e bardha, dhitë, kalikuq, ligos, qepa**; në dalipbeççe: bora, njerëzit, zjarri, e teproj, ora.

Të folmet tona shoqnore, për pasunimin e leksikut të tyne, kanë shfrytëzue arkaizma të gjuhës së përbashkët, fjalë dialektale, ose trajta, që kanë një përdorim të kufizuem. Në purishten p.sh. përdoren fjalët **arbër, farash, fjesë, këmbës, mënji, shtroje**, me kuptimin e bariut farashit, fshesës, napolonit, mëngjezit, dyshemes, në dogançe: **cakure, i kolmë, lëpushë, panxhë, sqile, tesha**, për sëpatë, i mirë (i bukur), letër, dorë, dhelipën, plaçka që punon një zanatçi.

Një numër fjalësh të këtyne të folmeve janë marrë nga lami i toponomastikës, janë emna krahinash, malesh, tokash, që tregojnë prejardhjen e prodhimeve përkatëse. Kështu p.sh. në purisht: patatja, domatet, sheqeri, thirren me emnin e krahinave që i prodhojnë (ose që mendohet nga masat popullore se janë vendburimi i tyne), përkitazi: **t'devolli, t'misirit, t'radanecit, t'gjiritit**, në dalipbeççe tëlyenit i thonë **mcek-simbas** emnit të malit ku kullosin gjanë; bukës — **aratesh** (emni i vendit ku kanë arat e bukës katundi Shëngjergj), druve — të mjetnës (Mjetna pyllë i katundit Shëmri), gizës: **Kërçovë krypës: Kavajë**.

Në këte të folmen e fundit, në dalipbeççen, janë shfrytëzue në një shkallë të gjanë emnat e përveçëm të njerëzve. Dalipbeçça, sikundër thuhet edhe ma sipër, asht një e folme qëndrore, që nuk ka pasë mundësi të shfrytëzojë as gjuhët e popujve fqinj, as ndonji të folme të pakicave kombëtare; prandaj ajo ka qenë shtrëngue t'i drejtohet, për pasunimin e fjalorit të saj, këtij burimi, i cili asht shfrytëzue edhe prej të folmeve shoqnore të popujve të tjerë. Emnat e përveçëm të njerëzve janë përdorë këtu simbas tipit të karakterit të tyne, të metave fizike, vetive morale e humoristike që kanë spikatë ma tepër në to; p.sh. emni i një memeci të katundit, Met Osmani, asht përdorë me kuptimin **pusho, mos fol, (metasman se nashi balliu: mos fol se erdhi i zoti i punës)**; emni i një mullisi, Rrap Gaçi, për të tregue mullinin, mullisin, miellin

(a nashe në t'rrapaçit: a shkove në mulli? A e more t'rrapaçit: a e more miellin?); emnat e bashkëkatundarëve që kanë qenë dallue në prodhimin e përdorimin e ndonji produkti bujqësor e blegtoral, kanë shërbye si fjalë për të emnue llojet e këtyne prodhimeve: **met'hysë**; **grosha**, **ramkolë**: djathi, **suldome**: duhani, **braisinë**: rakia (Met Hysa prodhonte groshë me shumicë, Ram Kola djathë të mirë, Sul Domja pinte shumë duhan e Brahim Sina ziente raki).

Prirjen drejt ironisë që ka gjuha në përgjithësi — prirjen për krijime termash të sferës humoristike — dalipbeçja e ka shfrytëzue në një shkallë të gjanë. Formime ironike ka në të tana gjuhët: në xhergot italiane përdoren shprehjet **andare allo studio** për «me shkue në burg», **inganna popolo** për «deputet», **mumma** për «gjykatësit e naltë», **maccellaio**, **massacro**, **tagliabue**, për «kirurg». Në argotë franceze **le comte de la carruche** quhet gardiani i burgut, **le mouton**: agjenti i policisë, **bûche** shkrepësja, **kilomètre**, makaronat. Dalipbeçja ka formue terma e shprehje të tilla në bazë të tipareve morale e fizike ma të spikatuna të banorve të krahinës: **sufaritë e Bafam Kullakut** quhen xhinitë (e kanë kapë, ose i kanë hypë **sufaritë e Baram Kullakut**: e kanë kapë ose e kanë zanë xhint. Bajram Kullaku ka qenë si i prishun), **qorrballë** thirret sopata (Qorr Balla ka pasë vra njerëz me sopatë), **t'aldremxhiut** quhen brekët, se Ali Dremxhiut i vareshin brekët nëpër kambë), **limobebë** thirren morrat (Limon Beba ish i njoftun si morracak). Disa prej këtyne termave kanë një origjinë anekdotike. Kështu **baj imerbeng** do të thotë vjedh, se Imer Benga kish vjedhë dikur një ka në Shëngjergj; **ka dalë me metlugë në krah**: ka dalë me torba në krah, se Met Luga kishte pasë lypë me torbë në shpinë në ato anë.

Siç vihet re, shumica e fjalëve të dalipbeçes janë dhanë me perifraza. Kjo mënyrë formimi, e cila asht e njoftun edhe në gjuhë të tjera, pasqyron një farë vorfnie krijuese të të folmeve që nuk kanë mundësi të praktikojnë rrugë të ndryshme pasunimi.

E kundërta ndodh me sinonimet. Të folmet shoqnore dallohen për pasuninë e tyre sinonimike, sidomos për termat që kanë një karakter emotiv — për nocione si vras, xhandar, polic etj., kështu përdoren fjalë: **pullos**, **pikos**, **crof**, **gris**, **fyp**, **thartoj**, për vras; fjalët: **shufërzi**, **tortëzi**, **shkopës**, **i veshur**, për agjentin e sigurimit publik. Në këte fenomen ndihmon edhe fakti se shumë fjalë krijohen nga nevoja imediate dhe nga interpretimet të çastit, që bazohen mbi veti ekspresive të objektit. Me fjalën **rrotës** cilësohet mullini po edhe makina; **halës** quhet peshku, gruni, elbi; **uji**, shiu thirret edhe **duno** edhe **lagun**.

Përsa i përket gjanësisë së sferave të fjalorit të të folmeve shoqnore, asht për t'u vu në dukje se kjo kushtëzohet me profilin e zejeve të grupeve shoqnore që i flasin. Kallajxhijtë e Brezhdanit e kanë ma të pasun terminologjinë që lidhet me zanatin e kallajxhiut, te dervishët e Leskajt asht zhvilluem ma tepër sfera e fjalëve e shprehjeve që kanë të bajnë me veprimet e tyre fetare, te xharenjtë e Bukalit sfera e praktikës empirike mjekësore, te sharraxhitë e Rrëzës së Përmetit terminologjia e punimit të drunit, te muratorët e Oparit ajo e teknikës së ndërtimit etj. Në përgjithësi fjalori i këtyne të folmeve përmbledh elemente që pasqyrojnë veprimtarinë e grupeve që i përdorin, rrethanat jetësore dhe nevojat praktike të këtyne grupeve.

Fjalori i të folmeve tona shoqnore përbaht kryesisht prej emnash, mbiemnash e foljesh, Ndajfoljet, numrorët dhe sidomos përemnat janë

shumë të kufizueme si formime të veçanta. Për këto të fundit shfrytëzohen zakonisht fjalët përkatëse të gjuhës së përbashkët. Si emna përdoren ma shumë mbiemnat dhe pjesoret e foljeve, të cilat në mjaft raste vishen me funksione substantivash: **e lyerme**; **baltë**; **i koçtë**; djathë, **i paleshtë**; **gur**; **të terme**; **para**; **rrjedhie**, **djegie**, **shkelje**, **lidhje**.

Në ndërtimin e fjalëve përdoren afikset dhe skemat e formimit të fjalëve të gjuhës së përbashkët. Në një shkallë jashtëzakonisht të gjanë, futen në përdorim mbrapashtesat, të cilat rruajnë vlerën e tyre të përgjithëshme. Një varg emnash formohen me mbrapashtesën karakteristike të emnave veprues, e cila i shtohet zakonisht pjesoret e foljeve: **lëpirës**, **ngulës**, **pështjellës**, **shkumbës**, **mbathës**, **shkrepës**, po edhe emnave e pjesëve të tjera të ligjëratës: **këmbës**, **konës**, **halës**, **syrës**, **tymës**, **tytës**, **thumbës**, **tringëllimës**. Të shumta janë gjithashtu pjesoret e substantivume të tipit: **falje**, **mbytje**, **mbathje**, **thurje**. Në analogji me to janë formue edhe emna si **sotje** (nga **sot** + **je**: ditë). **dremje**, **rrethje**. Sufikset pejorative kryejnë të njëjtin rol: **shanuq**, **thanuq**, **sharrok**. Në të folmet tona shoqërore gjejmë gjithashtu me të njëjtin funksion që kanë në gjuhën e përbashkët mbrapashtesat **ar-are**, or: **lovidhar**, **thumar**, **lidhar**, **dardhare**, **bykare**, **kungullor**; mbrapashtesat e emnave kolektivë: **Thumbëri**, **Ckulëri**; të mbiemrave: **i gruthmë**, **i thantë**, **i bëshëm**; mbrapashtesat e banorve: **ot-alli**: **gardhiot**, **gardhalli**; të zanateve: **tekëthxhi**; mbrapashtesat zvogëluese e përkëdhelëse: **njomëzë**, **bimëz**, **shtëngëz**, **tudëz**, **gjonth**, **koçth**, **prockth**; mbrapashtesat foljore: **-oj**, **-is**, **-as**, **-it**, etj.: **drangulloj**, **qezëroj**, **vakërooj**, **forfolis**, **foradhis**, **rrokanis**, **vardis**, **cipëzos**, **lukros**, **thumbos**, **pllavit**, **qestrit**, **lukrat**, **zhavat**, **vëshgjept**.

Në shkallë pak a shumë të gjanë përdoren në këto të folme kompozita të llojeve të ndryshme: emën + emën, emën + mbiemën, emën + pjesore, numror + emën, këmbëvije, **vuturleb**, **halmadh**, **bishtgjat**, **zhapëzezë**, **mostokuqe**, **kokëpështjellë**, **katërkëmbje**.

Të folmet tona shoqërore kanë praktikue në formimin e fjalëve, alternacione morfologjike (kanë krijuar trajta të njëjësit nga shumësi etj.), kontraksione fonetike (në zgjedhimet e foljeve, lakimet, etj.), aglutinime e çaglutinime (në mbiemnat e nyjshëm, pjesoret e substantivume, etj.), atraksione paronimike (në formime simbas etimologjisë popullore).

Me shumë interes paraqitet studimi i procesit semantik — i mënyrave me të cilat fjalët e krijueme të këtyne të folmeve vishen me kuptimin e tyre të veçantë. Duhet pasë parasysh se si në formimin e fjalëve nga pikpamja e trajtës së jashtme ashtu edhe në përcaktimin e kuptimit të tyre, të folmet shoqërore bazohen në skema që gjejnë në gjuhën e përbashkët. Në këte fushë shfrytëzohet në një shkallë mjaft të gjanë **metafora**. Me anë të kësaj figure kaqë të zakonëshme të gjuhës së përditëshme, termat shpërngulen nga një koncept, në të cilin përdoren posaçërisht, në një koncept të ri, që paraqet me të parin ndonjë ngjajshmëri tipike: mullini thirret **rrotës**, peshku **halës**, hunda **erës**, brezi (i murit) **lidhar**, koka **gjalpishte**. Nga pikpamja formale, metafora mund të shprehet me anë të një emni, mbiemni a pjesorje (këto dy të fundit në funksionin e tyre të thjeshtë ose të mbiemrave të substantivuem). Metafora nxjerr në reliev një cilësi ekspresive të sendit ose të nocionit. Kjo mund të jetë e sferës pamore, të ketë lidhje me ngjyrën e objektit: **e bardha** (në dalip-bebçe bora), **e zeza** (në purisht kafja), **mostokuqe** (në dogançe uthulla); mund të lidhet me formën: **rrumbullake** (ambëlsina), **qepë** (sahati); me pamjen e jashtme në përgjithësi: **katërkëmbja** (mushka), **kokëpështjellë**

(hoxha), **halmadh** (elbi), **këmbëveçe** (revolja), **gjatje** (rruga), **kungullor** (zyrtari — njeriu që punon me kokë — kungull), **lëpjetë** (gjuha).

Tipari dallues që merret si bazë në këto sajime mund të përfaqësojë një cilësi objekti: **i lagur** (uji), **i kalbur** (ambëlsinë), **i thatë** (gur), **të terme** (pare), **i leshtë** (i krishten), **i dhirtë** (muhamedan), **i thantë** (i keq), **djegje** (qepa); **i lymë** (gjalpë), ose një funksion karakteristik të tij: **mjelje** (sisë), **shtroje** (dysHEME), **falje** (kishë, xhami), **mbytje** (gizë), **rrethje** (dasëm), **erëz** (hunda), **lëpirës** (sahan), **tymës** (duhan, oxhak), **dardhare** (torbë), **bykare** (kasolle), **dremje** (mendje — që peshon me drehem?), **shkelje** (kambë), **mbathës** (çorap), **vardje** (punë), **heqje** (okë). Mbi tiparin e funksioneve bazohen gjithashtu foljet metaforike: **thanos** (rrah), **zbardh** (laj), **dredh** (ha), **fryj** (iki), **lodhem** (vij), **mërzej** (la, pushoj), **vardis** (punoj), **pullos**, **pikos**, **gris**, (vras). Disa folje e emna kanë origjinë onomatopeike: **drangulloj** (lexoj), ma tepër për fetarët që lexojnë librat e shejta), **cërret** (paret); në disa fjalë bahen zavendësime midis objektesh a qeniesh të një familje: **çimkë** (në dogançe morrit), **çotë**, **çotash** (pulës gjelit; nga emni i një shpendi — garrulus glandarius), **çotur** (sahanit). Veshët thirren **duqe** (në analogji me dujqit që ngarkohen në të dy anët e kafshës), uji, shiu **-duno** (nga Dunau — Tuna); qeni — **bishto** (me sinekdokë — pjesa në vend të së tanës, suvaritë, zaptijet, policët: **shufërzi**, **tortëzi**, **shkopës**, **të veshur** (nga funksioni dhe uniforma që i ka pasë karakterizue).

Një burim tjetër i randësishëm për pasunimin e fjalorit të të folmeve shoqnore, sikurse asht thanë edhe ma sipër, janë gjuhët e hueja. Fjalorin e të folmeve tona e kanë ushqye, në radhë të parë, gjuhët e popujve fqinj: greqishtja dhe sllavishtja. Nga gjuha greke kanë hy në dogançe fjalët: **allaksem**, **aniks**, **aspra**, **cuvala**, **dhendia**, **evllomadhë**, **fillo**, **gambrea**, **gligora**, **haraja**, **ilja**, **kalqeria**, **kapna**, **karfia**, **koraf**, **kronjë**, **liko**, **llambaq**, **mavro**, **merja**, **minë**, **misoj**, **nomat**, **potami**, **promozitër**, **qimon**, **qinurie**, **skupis**, **skupje**, **stakth**, **stomë**, **shidhro**, **tiko**, **vraqo**, **vuno**, **zahar**. Në të folmen e muratorve të Oparit numri i greqizmeve asht i kufizuem: **avgë**, **graps**, **kronjë**, **llogë**, **pirjona**, **stafs**. Në këtë të fundit si gjuhë e huej bazë, që ka ndihmue në pasunimin e fjalorit, ka shërbye gjuha aromune, e cila flitet në katundet rreth e rrotull (Voskopojë, Shipskë, Grabovë, etj). Nga aromunishtja janë marrë hua fjalët: **fok**, **frate**, **frine**, **glinë**, **(glinës)**, **granë**, **kapllo**, **kapre**, **kelishte**, **kane**, **leme**, **lingur**, **lukër**, **(lukros)**, **llane**, **llapte**, **mere**, **mullte**, **muriti**, **njigëzë**, **ojle**, **përk**, **pllavit**, **sale**, **sare**, **slamë**, **strale**, **tali**. Në dogançe kanë hy nga kjo gjuhë fjalët: **lukur**, **lukrat**, **çkëndje**. Mund të vihet në dukje, në vija të përgjithëshme, një farë përpjestimi midis elementëve të huajtuna nga këto gjuhë në dy të folmet tona të naltpërmenduna, sasia e elementëve të huajtuna prej dogançes nga greqishtja u përgjigjen sasisë së huajton nga aromunishtja prej purishtes, ndërsa numri i elementëve greke në purisht u përgjigjet atij të elementeve aromune në dogançe. Elementët sllave duken si ma të shumta në dogançe se sa në purisht, megjithëqë nga pozicioni gjeografik duhet të ndodhte e kundërta. Në dogançet gjejmë fjalë nga sllavishtja si: **derva**, **jaica**, **majkush** (majkushe), **sello**; ndërsa në purisht: **domë**, **mleko**, ndoshta edhe fjala **rast** (nga sl. **rastiti**).

Gjuha turke, si një gjuhë që njihej deridiku nga populli dhe nga organet qeveritare, ka pasë një ndikim të kufizuem në formimin e fjalorit të këtyne të folmeve. Prej kësaj gjuhe janë huajtë fjalët: **degërmen**, **karakash**, **pirinç**, **qoi**, **qylanbé**, **yzmets**.

Të folmet shoqnore në pasunimin e fjalorit të tyne shfrytëzojnë edhe fjalë nga gjuhë të jashtme, me të cilat gjuha e përbashkët ka pasë marrëdhanie të ndryshme historike, ose nga gjuhë të tjera të huaja, që rrojnë mbrenda territorit të gjuhës së përgjithëshme të vendit, në një mënyrë jo shumë të njohun nga masat. Kështu argotë frenge dhe xhergot italiane kanë shfrytëzue fjalë të gjuhëve arabe, turke, cigane, hebraike¹³). Nji element të randësishëm cigan ka germania e spanishtes, ndër-sa rotvelshi i gjermanishtes asht i mbushun me fjalë hebraike.

Një burim i randësishëm i kësaj natyre që asht përdorë mjaft prej dialekteve shoqnore të Ballkanit, deridiku edhe prej të folmeve tona, asht gjuha e ciganëve, arixhishtja. Nga kjo gjuhë kanë hy në purishten, dogançen etj. fjalët **panell**, **nashell**, **skorell**, **pure**. Ndonji element i të folmeve tona si **manxha**, **pane** etj. mund të jetë me prejardhje nga italishtja mesjetare, venecianishtja.

Asht thanë se në fjalorin e të folmeve shoqnore figurojnë rregullisht tri kategori gramatikore: emnat, mbiemnat dhe foljet. Kjo ndodh jo vetëm për faktin se këto nocione janë ma konkretë, por edhe për lehtësinë që paraqesin në ndërtimin e tyne me përdorimin e afikseve të ndryshme. Midis këtyne kategorive vendin e parë, përsa i përket gjanësisë, e kanë emnat. Me këtë funksion vishen formime mbiemnore, perifraza, kompozita e pjesore të substantivume: i **lagur** (shiu), të **terme** (paratë), i **leshtë** (i krishteni), i **dhirtë** (muhamedani), **braililë**, (Brahim Tilë-dielli) **haxhikollakët** (xhandarët), të **devollit**, të **radonecit**, **katërkëmbje**, **në-hundje**; të **plerosurit** (pagesa), të **dredhurit**, (ngranja).

Formimet ndajfoljore, ndoshta nga pamundësia e një vije produktive krijuese, të ngjajshme me ato të formimeve metaforike të emnave, mbi-emnave e foljeve, janë të kufizueme. Edhe ato pak fjalë që janë krijuar nga kjo sferë u përkasin kryesisht huazimeve nga gjuhët e hueja: **okso** (jashtë), **nullto** (shumë), **nigëzë**, **njigëzë** (pak). Në përgjithësi përdoren ndajfoljet e gjuhës amtare: tani, sot, nesër, etj. **Ku do fryc tani?** (Ku do të shkosh tashti?) **Sa qero ja pëlçet këteja?** (Sa kohë ke këndej?).

Të gjuhës së përbashkët janë gjithashtu numrorët themelorë e rrjesh-torë, me përjashtim të dhetës, qindshit e mijës, të cilat ose janë huajtë nga gjuhë të hueja (si **dheka** për dhjetë) ose janë formue nga elementë të shqipës (si **zhapë** a këmbës për 100): **Fryni të dy**. **Zogosni pesë zhapa**. (Shkoni të dy. Kërkoni pesëqind lekë).

Në disa dialekte shoqnore të popujve të tjerë, si p.sh. në argotë frenge, përemnat kanë formime të veçanta. Te ne nuk ndodh një gja e tillë. Krejt përemnat në të folmet tona janë marrë nga gjuha e përbashkët. Duhet pasë parasysh se përdorimi i tyne në bisedë bahet me rezervë. Follësi e shpreh shpeshërë këtë kategori gramatikore në një mënyrë perifrastike ose tue dhanë drejtpërdrejt emnin të cilit i referohet. Kjo ngjan ma tepër në raste kur përdorimi i përemnave në gjuhën amtare ka rrezik të komprometojë bisedën (kur asht fjala për të zotin e punës, agjentët e sigurimit publik etj.). Kështu nuk thohet: **Po të zogos (kërkon) ky**, por **po të zogos sharroku, shkopësi, shufërzia** (qoftë edhe përpara tyne). Në raste të tjera përdoren përemnat e zakonshëm **Logos për nonjë ngulës. Ai s'rruc dogançet! Si rokanis ti, sa t'i qëroj?**

13) A. Menarini në studimin e tij **Contributi gerghali** f. 503-504, përmend fjalën turke **kajmekam** që ka hy në xhergon fiorentine me trajtën **caimacà** për kryetar, fjalën cigane **gaxho** me trajtën **gaggio** për katundarë, viktimitë e ambulantt; fjalët hebraike **ganav** (heb-haidut) me trajtën ganaviare për foljen me vjedhë; **jodio** (jahudi, hebre) për i ndershëm; **nada** për asgja.

Parafjalët, lidhëzat, nyjet dhe pasthirrat merren gjithmonë nga gjuha e përbashkët: **S'kemi ngrecuar këtej, për të legosur gorret, se na fyp me tytës kemi. . . po të vardisim kol në këto gardhëra, . . kur të dushkatim në Vakërr. . . u, u, u, ngrecoi majkushi!**

Kuptohet nga këto të dhana se fjalori i të folmeve shoqnore, edhe kur asht një fjalor i veçantë, nuk shkëputet prej fjalorit të gjuhës të përbashkët. Ai merr nga kjo gjuhë dhe përdor me funksione identike disa kategori gramatikore (përemnat, pjesërisht ndajfoljet, nyjet, lidhëzat, parafjalët), të cilat, tue pasë një karakter kuptimor të përgjithshëm, nuk rrezikojnë edhe kaqë mshehtësinë e bisedës.

Por lidhjet ma të thella dhe ma të ngushta me gjuhën amtare, këto të folme i kanë, siç asht v u në dukje edhe ma nalt, me sistemin gramatikor. Nëqoftëse në fushën e leksikut janë krijue, për disa pjesë të ligjëratës, fjalë të veçanta, në sistemin gramatikor nuk ka në këto të folme asnjë formim të veçantë, asnjë normë e rregull të re, të krijueme jashtë gjuhës së përbashkët. Pikërisht për këte arësyë — sepse nuk kanë një sistem gramatikor të vetën — nuk mund të bahet fjalë në rastin e tyne për gjuhë të veçanta, artificiale, konvencionale, etj.

Mbi sistemin gramatikor të gjuhës së përbashkët bazohet p.sh. formimi i shumësit të emnave dhe mbiemnave: **rojç - rojçër, fyç - fyçër a fyçër, çipul - çipuj, ngërfezi, ngërfezes**. Emnat e kategorisë ngulës, konës, këmbës, mbathës, halës dalin në shumës me -e: ngulëse, konëse etj. ndërsa emnat si **sharrok, shanuq, skorell, çotash, kungullor, gardhiot** me ë: **sharrokë, shanuqë**, etj. Mbi skemat e këtij sistemi mbështetet formimi i emnave femnorë nga mashkullorët ose anasjelltas: **bozil - bozilkë, kokosur - kokosurkë, koran - koranicë, bolo - bolovicë, majkush - majkushe, fyç - fyçe; çotë (pulë) çotak - çotash (gjel), glinë (pulë) - glinës (gjel)**.

Zgjedhimi i foljeve bahet simbas paradigmave të gjuhës së përbashkët: **vakërroj, vakërroi, vakërrojme, vakërroi, vakërrojnë; vakërrova, vakërrove, vakërroi, vakërroam, vakërruat, vakërruan; vakërrojnë, vakërrojnë, vakërrojnë, vakërrojnë, vakërrojnë, vakërrojnë; do të vakërroj, kam vakërruar**. Foljet ndihmëtare të kohëve të përbame merren gjithmonë nga gjuha e përbashkët: **kam drangulluar, në lëpushkën e bëshme (d.) kishën zhvatur rojkun, se s'u lothte çibuket (p.); jam pykosur nga vardja (d.); ngaj ishin lodhur ata pure? (p.)**. Por, kur këto folje nuk kryejnë një funksion ndihmëtar, zavendësohen me formime të veçanta. Kështu p.sh. në dogançe foljet **jam** e **kam** janë zavendësue me foljen pëlças: **Në ja pëlçet vardje kol, qapoje ngulsin le të ja pëlçasi hakën të plerosurit (Po të ketë punë mirë, zene konakun, le të jetë e naltë pagesa)**. Në dalipbeçen këto folje zavendësohen shpesh herë me foljen **shlij**, e cila përdoret me një tog vështrimesh (**kam, jam, baj, ha, pi**).

Mënyra e ndërtimit të fjalive, lidhja, renditja e koordinimi i tyne, i përgjigjet plotësisht sistemit sintaktik të gjuhës së përbashkët: **Jo, o këmbës, s'ja pëlças të butza, po turëm më një dukare, sa të dufri e ftomë një zogëz gjith, se u pykosa. Ai më rokanisi: do dushkatësh, apo të xdhës bishtot të të dredhin. . . Dolla në pazot e po mërxeje atje ku ishin kuspulluar nomatët, që zogosnin vardje dhe ngreconin këmbset, për të qëruar nomatët për vardje. Ngrecuan katër këmbse, zogosnin nomatë. Po legosje unë. Mua s'më rokaniste njeri, s'po më qëronin. I rokanisa një këmbësi: Qëromë o këmbës. Ç'të zogos tyja, ti je i cimbër, s'vardis dot. Ti qëromë, po s'vardisa, mos më fto besho. . .**

Tue shqyrtue fjalët e të folmeve tona shoqnore nga pikpamja e origjinalitetit dhe e pikave të përbashkëta që paraqesin me njana tjetrën, vemë

re se dogançja, purishtja dhe dalipbeçja, kanë arritë të formojnë sejcila një fjalor të vetin të veçantë, me përbamje dhe tipare karakteristike origjinale (për formimin dhe tiparet e tyre do të flitet gjanësisht në kapitujt ku do të trajtohen posaçërisht këto të folme). Kur krahasojmë fjalorin e lovidharçes me të dogançes dhe ate të çorkishtes me të purishtes shohim se ndryshimi që qëndron midis tyre, nuk asht i njëjlojtë me ate që ekziston midis fjalorëve të tri të folmeve të naltpërmenduna. Le të marrim p.sh. fjalorin e lovidharçes. Aty do të gjejmë fjalë të fondit themelor të dogançes si: **rruc, dredh, shoros, bogdanis, çkërth, kastis, civrisem, dufrij, ngrecoj, i kolmë, të bitës, cimadh, lëpushkë, garth, duno,** etj. Krahas këtyne elementëve të përbashkët ne gjejmë aty edhe ndryshime të dukëshme. Piksëpári lovidharçja ka zgjanue sferën e terminologjisë së mjeshtërisë së folësve të saj, terminologjinë e punimit të drunit, me terma si: **leke, lekthine** (sëpatë), **lekthos** (latoj, gëdhend), **lovidhar** (sharraxhi); **lovidharçe, gjatës** (tra), **mojtho** (patavra), **gjerje** (dërrasa), të cilat nuk kompensohen në fjalorin e dogançes me elementë të terminologjisë së kallajxhive. Ka mandej disa objekte e funksione që thirren ndryshe në lovidharçe, ndryshe në dogançe. P.sh. **kafja, druni, ora, dhitë, gruni,** foljet **ha, za,** në lovidharçe epen me fjalët **zhapzezë, grojës, qepa, ballaxhuret, halës, çjerr** (tjerr), **përfyt,** ndërsa në dogançe me **shkrumbje, shtengëza, tringëllimëzi, tokjet,** të **leshhtë** (të lezhdër), **dredh, qapo.** Megjithqë në vetë folësit e lovidharçes jeton ideja se e folmja e tyre asht shpikë nga malshovitët, të cilët, kur kuptojshin se u zbulohet sekreti i ndonji fjale, e ndryshojshin dhe e zavendësojshin me ndonji tjetër, këtu në formimin e këtyne fjalëve shihet një inisiativë krijuese e dyanëshme. Disa ndryshime të tjera prekin vetëm trajtën e jashtme p.sh. **dunaf** (1) **duno** (d.) **fofël - forfol, çotosh - çotak, brakush - majkush, jaritëza - jaica, gizëroj - qezëroj, boqës - mboqës, boo-bolo.** Sikurse shihet, këto trajta janë kryesisht shformime subjektive, që lindin në kushte të një shqiptimi jo të saktë të subjektit. Të njajtat vërejtje mund të bahen edhe për lidhjet që qëndrojnë midis purishtes dhe të folmes së muratorëve të Panaritit (çorkishtes) a të atyne të Orgockës e të Trebickës.

Fjalorët e tri të folmeve themelore — dogançes, purishtes dhe dalipbeçes — kanë lindë në rrethana shoqërore të veçanta, mbi një bazë materiale të pavarun. Fondin themelor të leksikut të dogançes e të purishtes e përbajnë fjalë të ambientit që na rrethon dhe të veprimeve të domosdoshme jetësore si **shtëpi, konak, djalë, vajzë, nanë, babë, motër, vëlla, plak, burrë, grue, mjeshtër, punëdhanës, dorë, kambë, këpucë, shi (ujë), diell, orë, ditë, natë, zjarr, lopë, dhi, kalë, mushkë, gomar, pulë, gjel, mish, qumësht, vezë, bukë, misër, grunë, fasule, gjellë, laknuer, para, duhan, sapun, gur, dru, i mirë, i keq, i sëmundë, ha, pi, punoj, flej, flas, baj, laj, pjek, këndoj, shkøj, vi, kuptoj, rri, vras, qaj,** të cilat epen radhazi në dogançe dhe purisht përkitazi me fjalët: **mojdë — domë, ngulës — kornës, cimath - bimth, cimadhe - bimëz, majkushe - fyke, majkush - fyk, fillushe - sortë, fillush - fratë, shidh - fyk, kokodhar - rrast, kokodhare** (goxhe, prokie, rrethje) - **krezhdë, kopaçe - pure, mëngres - rojk, panxhë - mëne, shkelje - shkelje, mbathje - caruqe, dapilo (laçko) - duno (dunaf, i lagur), ilja - balash, qepë - tringëllimëz, merje - sotje, zherrë - tertë, forfol-fok, bozilkë - bolovicë, tokje - bërre (kapre), derdojoll, katërkëmbje - bëtë, kapuq - spërr, çotë - glinë, çotak - glinës, balo - kërne, mleko-llapte, pemojkë (jaica) - avgë, gjonth-kronjë, mboqës - koqe-madh, të lehtë (telezhdër) - granë, coculla - françka, manxhë - file,**

shapkar - snak, kuc (kuce) - çibuke, nano - tymës, shkumbës - tgjiritit, palesht - çakall, shtëngëza - dërva, kol - i gruthmë, i thantë - jo i gruthmë, i zeganjepsur - spol, dreth - kre, shoras, vardis (foradhis) - lukros, dufri - dronjas, rrokanis - rinjshta-bog, citis - rij, çivris - pllavit, forfolis - fugos, drangulloj - këntac, fryj (dushkat), zhavloj (mzhyq), ngrecoj - lodhem, rruc - kre, mërxej - zhdec, fyp - crof, bogdanis - pllans. Siç kuptohet, pothuajse të gjithë këto formime leksikore të dogançes dhe purishtes, ndryshojnë krejt prej njani tjetrit. Kështu ndryshojnë prej tyne edhe fjalët e fondit themelor të delipbeçes: **shllij** (ha, baj, shoh, ndëgjoj, punoj, ap), **nash** (shkoj, vij), **aratesh** (bukë), **braikurt** (uj, shi), **ramkolë** (djath), **kërçovë** (gizë), **mcek** (tëlyen), **kavajë** (krypë), **imetes** (groshë), **njankë** (mish), **tkotes** (pulë), **kalikuq** (zjarri), **e zeza** (kafja), **e bardha** (bora), **braitilë** (diell), **qepa** (ora), **neli** (puna), **balliu** (pundhansi), **martaneshe** (grue), **dhitë** (njerzit), **dërvoz** (puntor), **iseballë** (murator, mur), **azgjatë** (lopatë), **dremxhi** (bel), **talçakrit** (të holla), **domusballuk** (i shëndoshë), **haxhikollak** (xhandar), **e males** (pushkë), **e beçit** (thikë), **xhafëdukë** (brisk), **metosman** (hesht), **i ligate n'she** (e teprove), **e bani imerbeng** (e vodh), **t'tabakut** (opinga), **ttahirkozarit** (kambët).

Me gjithë përbamjen e veçantë të sistemit leksikor të këtyne të folmeve, ekzistojnë midis tyne edhe pika të përbashkëta. Këto pika takimi rrjedhin nga burime të ndryshme. Ka fjalë që janë elemente të huajtuna në kushtet e marrëdhanieve që kanë pasë këta grupe zejtarësh me njani tjetrin. Të tilla quhen fjalët **balash**, **bëdë**, **bëjshëm**, **cimadh**, **bimëz**, **fyk**, **lodhem**, **shkelje**, që gjejmë në dogançe e purishte. Veç kontakteve direkte, një rol të randësishëm në bartjen e këtyne elementëve nga një e folme në tjetrën, kanë luejtë edhe katundet kufitare si Trebicka, Orgocka, Shalësi dhe Poda, të cilët ndodhen në zonën që ndan gjeografikisht territorin e këtyne dy të folmeve. Disa pika të tjera takimi e kanë burimin te një bazë e përbashkët huazimesh. Fjalët **mleko**, **jaice**, **kronj**, **koroni**, janë marrë nga e njajta gjuhë; pra ishte e natyrëshme që të kishin edhe të njajtin vështrim në të dy të folmet tona. Megjithatë vihen re edhe këtu interpretime që flasin për krijime të pavaruna. Fjalë **mleko** p.sh. në dogançe ruen trajtën dhe kuptimin që ka në gjuhën prej nga asht marrë (sllavishtja: qumësht); në të folmen e Vërtoptit **mleko** thirret kosi, ndërsa në purisht **leko** do të thotë djathë; fjala **koran**, si duket me prejardhje nga gjuha cigane, në purisht ka trajtën **koron** dhe përdoret me kuptimin e punëdhanësit; në dogançe me kuptimin e burrit në përgjithësi (me trajtën **koran**); fjala sllave **jaica** në purisht thohet edhe **occ**, ndërsa fjala **kronj**, nga greqishtja vit, ruen, në të dy të folmet, të njajtën trajtë e të njajtin vështrim. Disa pika të tjera takimi janë rezultat i përdorimit të së njajtës metodë në formimet e reja leksikore. Dihet se një nga rrugët e praktikueme në pasunimin e fjalorit të të folmeve tona shoqnore asht edhe ajo e shkurtimit të fjalëve. Kjo ka sjellë si rrjedhim formimin e një tog elementesh të përbashkëta në të dy të folmet tona (në purishten e në dogançen) si p.sh. **pazo** (pazar, qytet), **Tiro** (Tiranë), **parto** (partizanë), etj.

Së fundi një numër tjetër fjalësh të përbashkëta e kanë burimin te indentiteti i mendjes njerëzore. Ato janë interpretime të pavaruna të ve-tiave ekspresive të objekteve e fenomeneve të ndryshme. Si rezultat i një veprimi të tillë janë përfitue fjalë, që rruajnë të njajtën trajtë, po jo gjithmonë, të njejtin kuptim. Kuptimet e tyne shpeshherë kushtëzohen nga interesat e grupeve shoqnore që i kanë krijuet. P. sh. fjala **djegje** në purisht do të thotë tjegull, qeramidhe, kurse në dogançe qepë; fjala **köm-**

bës në purisht përdoret me kuptimin e napolonit, të njiqind lekëve, kurse në dogançe me kuptimin e **pasanikut**, fjala **dredhje** në purisht - **fije**, në dogançe — **ethe** e **pemë**. Këtyne elementëve mund t'u shtohen edhe çiftet **bishtgjatë - bishto** (e para e purishtes me kuptimin **ujk**, kurse tjetra e dogançes me kuptimin **qen**); **halmadh-halës** (në purisht **elb**, në dogançen **peshk**). Pika takimi të tilla shpjegohen me faktin se mendja njerëzore kur ndodhet para fenomenesh të njajtë, krijon edhe interpretime të njajtë ose të afërt.

Mbasi pamë në vija të përgjithëshme përbamjen dhe disa tipare karakteristike të të folmeve tona shoqnore, mund të thomi se **dogançja**, **purishtja** dhe **dalipbeçja** formojnë tri të folme të ndryshme, që kanë lindë në mënyrë të pavarun prej njana tjetrës, në kushte zhvillimi ekonomiko-shoqnore të veçanta, ndërsa **lovidharçja** e **çorkishtja** janë degëzime-përkritazi të dogançes dhe purishtes.

Me interes do të ishte të shtrohesh edhe problemi se sa këto të folme kanë qenë ndikue në origjinën e tyre prej të folmeve shoqnore të vendeve fqinjë. Mbrenda territorit të adheut tonë fliten edhe tri të folme të tjera shoqnore ndër pakicat kombëtare: **alifiatikaja**, e folmja e kallajxhive të katundeve Karroq, Grazhdan, Zminec, Malçan, të rrethit të Sarandës, **sopiqotçja** a **sopçja**, e folmja e bucelapunuesve të katundit Sopik, të dyja këto me gjuhë bazë greqishten, dhe e folmja e muratorve të Gollobordës (rrethi i Peshkopisë) me gjuhë bazë sllavishten. Të folme të tjera shoqnore, sikurse asht thanë, fliten në provincat greke e sllave që ndodhen rreth e rrotull vendit tonë. Ndikime reciproke midis zejtarëve shtetitës shqiptarë, grekë e sllavë, asht e logjikëshme që të ketë pasë, sidomos kur asht fjala për zejtarë që i kanë ushtruar mjeshtëritë e tyre dikur, jo vetëm mbrenda kufijve të vendit, por edhe jasht tyre. Por mundësia e një ndikimi direkt në lindjen e këtyne të folmeve, e një sajimi të tyre në bazë të një modeli të huej, asht e diskutueshme.

Ne pamë ma nalt se çashtja e pikave të takimit dhe e krijimit simbas një baze të përbashkët, ishte ngritë edhe për dialektet shoqnore simbas një baze të përbashkët, ishte ngritë edhe për dialektet shoqnore të popujve të tjerë të Europës. Linguisti englez G. Barrow kishte vu në dukje fjalët e përbashkëta provensale, greke, hebraike, arabe që hasen në dialektet shoqnore t'Europës Jugore dhe kishte formulue tezën e njoftun të monogjenezës, për krijimin e këtyne dialekteve. Linguisti freng, F. Michel, vinte re se kudo të folmet shoqnore bazohen në të njejtin parim: mbi parimin e metaforës¹⁴). Linguisti italian G.I. Ascoli, tue dashtë me kundërshtue teorinë e monogjenezës të formulue me nga G. Barrow, shënon-te se tipare të përngjashme ekzistojnë edhe midis argove të sektit a të kastës së Indisë Theg a Phansipar dhe argove europiane, por këto nuk duen të thonë se të tilla analogji varen nga një imitim a kopjim i thjeshtë. Të këtij mendimi janë edhe shumë linguistë të tjerë (Biondelli, Dauzat, J. Vandryes etj.). Pikat e takimit në fjalorin e këtyne dialekteve si edhe në skemën e ndërtimit të tyre, ata i shpjegojnë me njajtësinë e strukturës së mendjes njerëzore dhe me njajtësinë tipologjike të kriimeve të saj. Nji tezë e tillë mund të shtrohet fare bukur edhe për origjinën e të folmeve tona shoqnore. Muratorët e Oparit, kallajxhijtë e sharraxhinjtë e Përmetit, a belaxhijtë e Tomadhesë së Tiranës, kur krijuen të folmet e tyre të zanatit, nuk kopjuen, a nuk imituen dialektet shoqnore

¹⁴) F. Michel, *Etudes de philologie comparées sur l'argot*. XXIV.

të popujve fqinjë, po i ndërtuen ato në mënyrë të pavarun nga të njahtat nevoja, në të njahtat rrethana shoqnore dhe me të njahtat skema, që jetuen ose përdorën edhe grupet shoqnore të vendeve të tjera.

Disa dialekte shoqnore të popujve të ndryshëm të Europës, mundën të krijojnë edhe një farë letërsie, arrinë të konkretizojnë edhe ndonji punim letrar të shkruem. Janë të njoftuna në kët drejtim baladat e poetit freng F. Villon që u shkruen në argo në shek. XV-të, shkrimet e italianit Antonio Broccardo në xhergo në shek. XVI-të, tregimet e Juan Hídalgos në germania (Romances de Germania, Barcellona 1609) etj. Në të folmet tona shoqnore nuk duhet të ketë mbetë ndonji punim letrar i shkruem, por populli ynë i ka përdorë këto të folme në korrespondencën e tij ose në tregime humoristike të ndryshme. Në një katund të Përmetit, në Brezhdan, më ka takue të ndëgjoj në dogançe tregime rreth aventurave që bajshin jasht vendlindjes dervishët malshovitë. Ata që kuptojshin dogançen këputeshin së qeshuni me qyfyret e tyne, ndërsa gratë dhe profanët e tjerë mundoheshin të zbulojshin sekretin e kësaj atmosfere.

Gjithmonë në lidhje me dinamikën e të folmeve tona shoqnore mund të vihen në dukje edhe disa elementë leksikore të tyne që kanë mund të depërtojnë në përdorim të gjuhës së përbashkët. Disa prej këtyne elementëve, për shkak të ngjyrës humoristike, kanë pasë një shtrirje gjeografike të gjanë, ndërsa disa të tjerë nuk mund të përcaktohen mirë nëse janë elementë që janë marrë nga të folmet shoqnore dhe janë futë në përdorim të gjuhës së përbashkët, apo anasjelltas janë elementë të fondit leksikor të gjuhës së përbashkët që janë huajtë nga të folmet shoqnore, tue u veshë me një ngjyrë semantike të caktueme. Nga grupi i parë mund të përmenden fjalët: **Fryj** (shkoj, iki, largohem) dhe **thur** (baj, punoj, shkel e shko). E para asht e përhapun pothuajse në të gjithë Jugun: **Fryj tani** (ma tepër në vetën e dytë të urdhnores); ndërsa tjetrën e gjejmë deri në të folmen e Tiranës: «**t'ja ve gërshonët ene t'ja thur mo**. Nga dogançja duhet të jenë marrë fjalët **xeno** (frikë) i **venë xeno** nga **frika** (Fjalori i P. Tases), **umuri** (xherah); **ka ardhur një umuri, e shëroi një umuri, e ka t'anë umuri, filani është umuri**, fjalë që përdoren rregullisht në të folmen e përditshme të Përmetit. Fjalët i **kolm, e kolme** (të dogançes) janë përhapë në të gjithë Labërinë me kuptimin i **hiejshtëm, e hiejshme**¹⁵). Këto fjalë kanë hy edhe në letërsinë artistike: **Këtu brënda fle Dylqinja; seç këndonte si mëllinja! Ish e kolme rrumbullake, faqe-kuqe, pupulake**¹⁶), si edhe në ndonji tekst të letërsisë popullore: **Vajti te plaka, pa çupënë vërtet fort të kolme edhe kudo ajo, i mbinte lëndinë... kjo plak' adha posa pa këtë trim të ri e të kolmë**¹⁷). Fjalët **rokan e rokanis**, si duket me prejardhje nga greqishtja, i gjejmë si në dogançe ashtu edhe në të folmen e ndonjë krahine të Jugut: **c'rokanis kështu more? është një rokan ai** (Gjinokastër). Në një vështrim figurativ të tillë si edhe me kuptimin konkret të zdrukut, fjala **rokan** asht futë në fjalorin e Institutit të Shkencave (f. 467). Fjala **zhavloj** e purishes përdoret në Drenovë (Korçë) me kuptimin iki, shkoj: **aha zhavloi ai**; ndërsa në Pogradec me vështrimin përpiqem: **Është nisur pastaj ay në mes e trimat rreth e rrotull, e ka zhavluar të piqet me njëat...**¹⁸).

15) Fjalori i Institutit të Shkencave, faqe 223.

16) F. Noli, **Don Kishoti**, Botim i vitit 1956, f. 358.

17) Th. Mitko, **Dorëshkrimi i Pragës**, f. 109 e 115.

18) M. Kuteli, **Kapllan Aga i Shaban Shpatës**, f. 22.

Fjalën **shidhe-ja** të doganges (**shidh, shidhe, plak, plakë**) e gjejmë me të njëjtin kuptim edhe në Elbasan (**ik moj shidhe, kishte për gru 'i shidhe t'keqe**). Fjalën **shllij**, që formon një nga foljet bazë të dalipbeçes, e përdorin pothuajse krejt katundet e malsisë verilindore të Tiranës me trajtat **shllij, shllej** dhe me vështrimin **ha mëngjez, ha diçka të lehtë, ha shpejt e shpejt (po shllejm dy kapshore e po dalim në punë: Shupal)**. Këtyne shembujve mund t'u shtohen edhe elemente të tjera që i përkasin njëkohësisht si gjuhës së përbashkët ashtu edhe të folmeve shoqërore. Pa një analizë të hollësishme të prejardhjes së tyre, asht vështrirë të përcaktohet me saktësi se kujt i takon prioriteti dhe kujt huajta në përdorimin e këtyne fjalëve.

Të folmet tona shoqërore do t'i përmbledhim, në bazë të skemës së ndërtimit të tyre, në dy grupe: a) në grupin e parë do të grumbullohen ato të folme, që kanë si bazë komunikimi gjuhën e përbashkët, të shndërrueme me mjete alternimi mekanikë; b) në të dytin, të folmet që kanë mbërrirjtë të formojnë një fond leksikor të veçantë, të krijuem mbi fondin leksikor të gjuhës amtare dhe të ndonji gjuhe tjetër të afërt, me një aftësi komunikuese të pavarun.

Të folmet e grupit të parë janë të thjeshta edhe shquhen nga një ngjyrë humoristike si dhe nga një karakter mshehtësie jo të thellë. Ato qëndrojnë të pakuptueshme nga ambienti, sa kohë që nuk njihet sekreti i formimit të tyre, por, posa bie ky sekret, humb edhe funksioni i përdorimit të tyre me karakter të mshehtë. Të folme të kësaj natyre janë shumë të përhapura në vendin tonë. Ne kemi mundë të mbledhim të dhana për ekzistencën e tyre në Shkodër, Lezhë, Tiranë, Kavajë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Vlonë, Gjinokastër. Ato njihen edhe ndër katunde si në Malsi të Madhe të Shkodrës, në Ogren e Kosovë të Përmetit, në Buz të Tepelenës etj. Të folme të tilla rojnë a) në ambiente intime familiare e shoqërore; b) në sfera të zanateve, të përdoruna kryesisht prej çirakësh; c) në rrethe studenteske. Në skemën e ndërtimit të tyre shfrytëzohen elemente të ndryshme me një karakter të jashtëm, mekanik, siç janë p.sh. shtesa e rrokjeve argotike, heqjet, shpërnguljet e germave, rrokjeve etj.

Forma ma e thjeshtë e këtyne të folmeve paraqitet e kështuqejtuna **zejbekçe**. Kjo e folme, që përdorej në disa lagje të qytetit të Tiranës, ndërtohej me shtimin e pjesës argotike **shte** ose **ishte** mbas çdo fjale: **A. Do-shte la-shte lever-ishte ne-shte?** (Do lash lëvere nesër?) **B. Jo -shte se-shte asht-ishte ko-shte e-shte keq-ishte** (Jo se asht koha e keqe). Emnave, mbas mbrapashtesës, u vihet mbaresa përkatëse e rasës: **Jam-ishte allnu-shte me-shte Asmon-isht-in** (Jom allnu me Asmonin).

E afërt me zejbekçen e Tiranës asht e folmja e Pogradecit që përdoret nga zavendësimi i rrokjes së fundit të fjalës me rrokjen argotike **fri**: **Sa-fri e-fri buk-fri qe-fri kjo-fri çu-fri** (Sa e bukur qenka kjo çupë). **Sa-fri i-fri ma-fri ve-fri ky-fri fshata-fri** (Sa i mban vezët ky fshatari). **Me-fri se-fri i-fri ka-fri të-fri mi-fri** (Merri se i ka të mira). Në fjalët njërrrokshë shtohet vetëm rrokja argotike. Mbaresat e numrit dhe të rasave të emnit zakonisht vehen në fund të tyre (**ve-fri-t**: vezët).

Malsorët e Malsisë së Madhe (të Mbishkodrës dhe ata që janë vendosë në rrethin e Lezhës) i deformojnë fjalët e bisedës tue përdorë gjithashtu pjesën **shte**: por, përpara shtesës së këtij elementi, ata bajnë edhe përsëritjen e fjalës. Fjala bazë thuhet e plotë, ndërsa përsëritja e saj e cingume. Të dy pjesët lidhen midis tyre me zanoren **i**: **Ku i kushte ke i keshte me i meshte shku i shkushte** (Ku ke me shkue). Fjalët me

ma se një rrokje në përsëritje shkurtohen: **mrizi i mrishte, guralecash i gurishte**. Po apim një fragment bisede të disa vajzave malsore të Ishullit të Shëngjinit (Shkrelase-Lezhë): A) **Mri i mrishte nesër i neshte dalim i dashte te i teshte mrizi i mrishte se i seshte atje i tjeshte vinë i vishte edhe i jeshte çobât i çoshte**. B) **Jo i joshte se i seshte na i nashte shohin i shohshte e i eshte na i nashte han i heshte dreqi i dreshte**. (A). Mri, nesër dalim te mrizi, se atje vinë edhe çobant. B) Jo se na shohin e na han dreqi).

E një natyre me këto asht edhe e folmja që përdorej nga vajzat e mbulueme të Elbasanit (vajzave që mbylleshin në shtëpi kur mbrireshin në një farë moshe të rritun). Në këto të folme kombinohet rrokja ose zanorja e fundit e fjalëve kryesore (zakonisht e fjalëve ku bie theksi ritmi i fjalës me dy sufikse të caktueme). P.sh. **Xhemile qypidhile taftifinile, do vish qypidhish taftifinish ke ne qypidhe taftifine sonte qypidhonte taftifinonte?** (Xhemile, do vish sonde ke ne?), Në të folme të tilla mund të errësohet kuptimi i ligjeratës vetëm nga shpejtësia e bisedimit. Të me të vërtetë këta kombinime thohen në këto rrethe me aqë shpejtësi sa e çorientojnë ndëgjuesin dhe s'e lanë të ndjeki fillin e bisedës.

Zavendësimi i rrokjes së fundit me sufikse argotike asht praktikue gjanësisht edhe në të folmet shoqnore të vendeve të tjerë. Në argotë frange janë të njoftun shformimet e fjalëve me mbrapashtesat-**bler** (crier-cribler), **ar** ose **mar** (arpagon - arpagar, guichetier-guichemar, épicier-epicemar), **mont** (gilet - gilmont,) **anche** (boutique -bou-tanche), **ingo** etj.¹⁹⁾ Në këto gjuhë praktikohet shumë edhe modifikimi i fjalëve me anë të shkurtimit a të heqjes së pjesës së fundit: **aristo (crate), can (on), champ (agne), comm (erce), estorn (ac)** etj. Të ne një mënyrë e tillë nuk asht përdorë për të formue një të folme të veçantë, por asht shfrytëzue për zgjanimin e fjalorit të ndonjanës prej këtyne të folmeve sidon os me elemente leksikore të rij. P.sh. në dogançe: **partot** (partizanët), **it t** (italjanët), **gjermot** (gjermanët), **ballot** (ballistat), **qevo** (qeveria), **çil t** (çilimijtë), **maço** (maçinë), **Tiro** (Tiranë), **kofo** (konferencë). Të vetmir rast të pavarun të kësaj natyre e kemi hasë në Përmet me shkurtimet e numrave: **ka (4), pe (5), gja (6), shta (7), te (8), në (9), njëmbë (11), dyn.bë (12), trembë (13), kambë (14), pembë (15), gjambë (16), shtambë (17), tembë (18), nëmbë (19), njezt (20), stenjë (21), stedy (22), stetre (23); tresh (30), trenjë (31), tredy (32), tretre (33), treka (34), dy e një (41), dy e dy (42), dy e tre (43), dy e ka (44), pesë (50), pesë e një (51), gjashë (60).**

Një vijë tjetër shumë e përhapun në vendin tonë për ndërtimin e të folmeve të tilla asht ajo e zgjanimit të sejcilës rrokje të fjalës me një rrokje tjetër argotike, të formueme nga një bashkëtingëllore të caktueme + zanoren e rrokjes bazë: **Do-fo shko-foj ke-fe te-fe-zja-fa** (Do shkoj ke te zja). Bashkëtingëlloret që çfrytëzohen ma tepër për këtë qëllim janë **f, s, k, th**. Gjinokastra dhe Vlona kanë përdorë ma shumë bashkëtingëlloren s: **U - su - në - së ja - sam nga - sa Vlo - so - ra - sa. Ne - se ke - se - mi - si fo - so - lu - su - rë - së kë - së - shtu - su ndë - sër - mje - set sho - so - qe - sesh, ku - sur do - so ni - sim ti - si tho - so - ni - sim ndo - so - një - së fja - sa - lë - së që - së të - së mo - sos e - se me - ser - te - se ve - sesh - të - së ndo - so - një - së sho - so - qe - se tje - se - të - sër. Një - së gj - si - to - so - ne - se i - si - me - se që - së ë - sësh - të - së nga - sa**

19) A. Dauzat — Vep. e për. fq. 137.

Gji-si-ro-so-ka-sas-tra-sa fle-set me-se mu-su-a-sa me-se kë-së-të-së gju-su-hë-së. (Unë jam nga Vlora. Ne kemi folurë kështu ndërmjet shoqesh, kur donim t'i thonim ndonjë fjalë që të mos e merrte vesh ndonjë shoqe tjetër. Një gjitone e ime që është nga Gjirokastra flet me mua në këtë gjuhë). Në katundet e Përmetit kanë folë me **k**; në Elbasan, Kavajë, Tiranë ma shumë me **f, s, k**. Në këto qytete të folme të tilla kanë qenë përdorë kryesisht prej elementit femnor — prej grave dhe sidomos prej vajzave të mbulue me — për të shprehur ndonji dëshirë intime, për të ba ndonji surprizë në familje etj. P.sh.: **Sa-fa i-fi bu-fu-ku-fur qe-fe-ka-fa ky-fy dja-fa-li-fi** (Sa i bukur qenka ky djali): **A-fa thre-fe-si-fim te-feze-fe. Ki-fi-je-fen so-fo-nde-fe. Mi-firë, po-fo ç'do-fo-ti-fi ba-fajmë pë-fër da-farkë? The-fe-rifim no-foj pu-fulë. Ço-fo pra-fa çu-fu-ni-fin qi-fi-ti-fi tho-fotë.** (A thresim teze Kijen sonde? Mirë, po çdo t'i bajmë për darkë? Therim noj pulë. Ço pra çunin t'i thotë). Po sjellim edhe një fragment tjetër bisede në këte të folme midis dy motrash: **E-fe ki-fi-shte-fe ha-fangë ma-fa-cja-fa mi-fi-shi-fin, mo-foj qy-fy-qe-fe. Do-fo-të-fë no-for-dhi-fi na-fana-fa se-fe-ti-fi e-fe ki-fi-shje-fe la-fanë do-fo-lla-fa-pi-fin çe-felë. Shko-fo e-fe i-fi thu-fuj ba-fa-bë-fës të-fë ble-fej mi-fish tje-fe-të-fër.** (E kishte hangë macja mishin, moj qyqe. Do të nordhi nana se ti e kishje lanë dollapin çelë. Shko e i thuj babës të blej mish tjetër). Në Shkodër këto lloj të folme kanë pasë hy edhe në rrethet e shegertëve²⁰, të cilët i përdorshin kur dojshir me vu në lojë ndonji veti të ustait p.sh. rreptësinë, kopracinë, fodullëkun e tij, kur vinte ndonji vajzë e bukur në dyqan etj. Por në përgjithësi ato mbeten si të folme tipike të rretheve familiare. Tue u nisë nga ky fakt, si edhe nga gjanësia e shtrimjes së tyre gjeografike këto të folme mund të mbahen si një fenomen gjuhësor i vjetër vendas. Populli i ka quejtë gjuhë zogu (Kavaja) ose thjeshtë zogjënisht (Elbasan).

Interesante janë edhe kombinimet e rrokjeve argotike që bahen nga rrethet e studentëve. Aty, qoftë nga ndonji ndikim i jashtëm, qoftë nga ngritja e tyre kulturele, përdoren kombinime të ndryshme të ndërlikueme si p.sh. mbas rrokjeve që formohen me **u** shtohet rrokja **furt**, mbas rrokjeve me **y**, rrokje **fyrt**, mbas atyne me **i, a**, rrokja argotike **iks**: **U-furt-në-ber fla-iks-së-ber me-ber një-ber -sho-ber-qe-ber-në-ber tiks-me-ber në-ber kë-ber-të-ber gju-furt hë-ber** (Unë flas me një shoqen time në këtë gjuhë).

E-ber da-iks-shu-furt-rë-ber mo-ber-të-bër-rë-ber! Ja-iks-më-ber mi-ks-rë-ber, kë-ber-të-ber dë-ber-shi-ks-ro-ber dhe-ber për-ber-rë-ber-ju-furt.

Me-ber më-ber-ks-me-ber ka-iks-më-ber shku-furt-a-iks-rë-ber mi-ks-rë-ber. Ta-iks-ni-ks ja-iks-më-ber në-ber pra-iks-gu-furt-në-ber e-ber-pro-ber-vi-ks-me-ber-ve-ber. Ka-iks-më-ber pë-ber-rë-ber të-ber dhë-ber-në-ber ka-iks-të-ber-rë-ber pro-ber-vi-ks-me-ber. Si-ks-do-ber më-ber-së-ber tre-ber pro-ber-vi-ks-me-ber i-ks ke-ber-mi-ks të-ber rë-ber-nda-iks, Ka-iks-më-ber ca-iks fri-ks-kë-ber. Nu-furt-kë-ber-di-ks si-ks do-ber të-ber da-iks-kë-ber. Ta-iks-ni-iks pë-ber-rë-ber-ta-iks-ni-ks mo-ber-së-ber më-ber pri-ks-sni-ks se-ber nu-furt-kë-ber ka-iks-më-ber ko-ber-hë-ber. Pa-iks-së-ber pro-ber-vi-ks-me-ber-ve-ber do-ber-të-ber ke-ber-mi-ks dhje-ber-të-ber di-ks-të-ber pu-furt-shi-ks-më-ber. Të-ber pu-furt-thë-ber. Mo-ber-tra-iks e-ber jo-ber-te-ber. Do-ber-ni-ks-ka-iks.

(E dashur motër. Jam mirë, këte dëshiroj dhe për ju. Me mësimë

20) Sipas kumtimit të shokut Z. Shkodra.

kam shkuar mirë. Tani jam në pragun e provimeve. Kam për të dhënë katër provime. Sidomos tre provime i kemi të rënda. Kam ca frikë. Nuk di si do të dal. Tani për tani mos më prisni, se nuk kam kohë. Pas provimeve do të kemi dhjetë ditë pushim. Të puth. Motra e jote Donika).

Sikurse vihet re, shtesa e rrokjeve argotike bahet gjithmonë mbas zanoreve. Për të lejue zbatimin e një parimi të tillë, fjalëve që mbarojnë me bashkëtingllore u shtohet zanorja ë (e dashurë motërë. jamë... kama... dëshirojë... përë... pragunë). Në rrokjet e mbrendëshme me pozicion të mbyllun bashkëtingëlloret lidhen me rrokjen që vijon: (prisni: pri-sni motra: mo-tra).

Këto kombinime formohen me aqë shkathtësi, sidomos prej vajzave, sa asht e pamundun të kuptosh bisedat e tyne. Modifikime të tilla praktikohen edhe në argot frange. Fjalën **bon** (i mirë) p.sh. ata që flasin me **lem** e bajnë **lonbem**, ata me **luch** — **lonbuch**, ata me **loque**: **lonboque**, me **dunon**: **nondubon**.

Shumë të praktikueme kanë qenë në rrethet tona shkollore edhe shformimet e fjalëve të gjuhës amtare me anë të metatezës e anagramës. Edhe në këtë fushë baheshin kombinime të ndryshme. Nxansit e ish shkollës normale të Elbasanit në vitet 1930-35 kanë pasë përdorë ma tepër çvendosjen e rrokjeve — vendosjen e rrokjes së mbrapme para së parës: **vete: te-ve, shkolla: lla-shko, muri: ri-mu, dera: ra-de, dora: ra-do, kama** (kamba): **ma-ka**. Në fjalët që përbaheshin prej tri rrokjesh, rrokja e parë kalonte zakonisht në fund të fjalës: **shtëpija: pija** — **shtë, hardhija: dhija-har, Hyseni: seni-hy, Nazmiu: miu-naz, Bajrami: rami-baj**. Por ndodhte edhe e kundërta: rrokja e fundit vendosesh në fillim: **shtëpija: ja-shtëpi, Hyseni: ni-hyse**. Fjalët me katër rrokje ndaheshin përgjysëm: **Ramazani: zani-rama, profesori: sori-profe**. Ndërsa në fjalët njërrrokëshe bahesh çvendosja e shkronjave — rrjeshtimi i tyne së prapthi: **keq: qek, jam: maj, kam: mak, rri: irr, shkoj: joksh; vjen: nevj, shpejt: tjepsh**. Një vendosje të tillë pësojshin edhe fjalët dyrrrokëshe që mbarojshin me e pazane: **mirë > mir: rim, pulë > pul: lup, gocë > goc: cog**. Me çvendosjen e rrokjeve, çvendosesh edhe theksi mbrenda fjalës. Gjuha e shformueme në këtë mënyrë të epte përshtypjen e një gjuhe monosillabike.

Këto modifikime, që njihen në letërsinë e përgjithëshme gjuhësore me emnin **back** — **slang**, kanë qenë praktikue edhe në gjuhë të tjera — në italisht: **presto: sto-pre, molto: to-mol**; në gjuhën angleze: **penny: vennep**; në frangjisht: **Toulon: lon-tou**. Në këte të fundit anagrama ndërlikohesh edhe me elemente argotike që shtoheshin simbas një kriteri të caktuem: **prince bahesh l-ins-pr-e, boucher: Poucher-b-em, quarante: l'arant-qu-e**.

Studentët tanë, sidomos ata që dalloheshin për humor e aventura, me këto të folme komunikojshin mbrenda dhe jasht klasës, me gojë ose me letër, dëshira e mendime që vijshin në kundërshtim me rregullat shkollore-kur dojshin t'ikshin pa leje nga shkolla, të bajshin kopje ndër provime, të pijshin ndonjherë duhan, të vijshin në lojë ndonji pedagog që mbahesh, që nuk shpjegonte mirë a që shkonte i papërgatitun në klasë. P.sh.: **Tos, kun maj gatit-pre re-fa; mjab rim ët dhem-vi rën-o e tyd. Oj es od an fi-shc tari-kujdes. Dehaj, dehaj som ik kirf.** (Sot nuk jam pregatitë fare; bajmë mirë të vidhem orën e dytë. Jo se do na shofi kujdestari. Hajde, hajde mos ki frikë). **Yk fesor-pro kun aj perksh re-fa** (Ky

profesor nuk ja shkrep fare). **A mjoksh e mjip inj han-du pa-pra llës-shko? Oj rom es od an pin-ka** (A shkojmë e pijmë nji duhan prapa shkollës? Jo, mor, se do na kapin). **Juth kap starit — kujde es Miu-naz ku-agn lla-shko es e uz ka-ko** (Thuj pak kujdestarit se Nazmiu iku nga shkolla se e zu koka)²¹).

Vajzat kanë komunikue me këto të folme ma tepër dëshira dhe ndjenja të sferës së tynë: inisiativa dashunie, njoftime rreth marrëdhënieve me djemtë, dëshira për takime etj. Ma poshtë po sjellim dy letra të shkëmbyeme më 1960 midis dy shoqeve nga Vlona: **Inel e rushad! Is ej? Aud ët jokat em someod tos. Is mak tënup rim em Nin-aul. Èt thup Atird** (Leni e dashur! Si je? Dua të takoj me doemos sot. S'i kam punët mirë me Luanin. Të puth Drita). **Atird e rushad! Èt serp ën ipëtsh sap ekerd, aro sep. Èt thup. Artom e etoj. Inel.** (Drita e dashur! Të pres në shtëpi pas dreke, ora pesë. Të puth. Motra jote Leni). Nji shoqe arsimtare i shkruen nji shoqeje që kish në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit Shtetëror të Tiranës: **Oram e rushad! Maj rim, ëtëk jorishëd edhe rëp yt. . . Nënup emit e nishik rram shev ën ipëtsh. Oja i shik ënëth ët tjallev edhe ia shik rushubm Nërolv. Rim ëm eshoth it rehta es oja ëtshë craqiliz. Op nu akçalladub kun ët avogjëd. Oram it is aj noç yta. Jeb fjeq, ejozëg nëtej. Ènu maj ërëb red utëk. Kun ak sa amenik, sa ënj ëgj. Kun mak sa ënj eqosh, sa ënj kosh. Maj mëtev. Tos arom rëtel agn Atird. U avozëg mush ëq i shik rudhra i ita agn Akirema. E ajmtev ëgj që ëm pej isëqanëk utëk ëtshë anup edhe tirukub e sërytan. Ha jom Oram as maronap ët rukub ëq ak utëk. Rukis ët shej it utëk od ët shehozëmyrf e od ët ejaurksh izeop ët arukub. Op ënu kun maj erartel, kun id ët jaurksh. Èm jaurksh tagj e regj is e nolak yta, is noksh em emisëm, em irëqosh e em odç ëgj rëtej. Èt thup em llam. Artom e etoj. Airotkiv.** (Maro e dashur! Jam mirë, këtë dëshëroj edhe për ty. . . Punën time e kishin marrë vesh në shtëpi. Ajo i kish thënë të vëllajt edhe ai kish mbushur Vlorën. Mirë më thoshe ti atëhere se ajo është ziliqare. Po unë budallaçka nuk të dëgjova. Maro si ja çon aty. Bën qejf, gëzoje jetën. Unë jam bërë der këtu. Nuk ka as kinema, as gjë. Nuk kam as një shoqe, as një shok. Jam vetëm. Sot mora letër nga Drita. U gëzova shumë që i kish ardhur i ati nga Amerika. E vetmja gjë që më jep kënaqësi këtu është puna dhe bukuritë e natyrës. Ah, moj Maro, sa panoramë të bukur që ka këtu. Sikur të jesh ti këtu do të frymëzohesh e do të shkruaje poezi të bukura. Po unë nuk jam letrare, nuk di të shkruaj. Më shkruaj gjatë e gjerë si e kalon aty, si shkon me mësimë, me shoqëri e me çdo gjë tjetër. Të puth me mall. Motra jote. Viktoria).

Me shumë lehtësi flitet e folmja së prapthi edhe nga djemtë në qytetin e Vlonës. Këta e kanë përdorë në ambientin shoqnor, shkollor e familjar — kur nuk dojshin të kuptoheshin prej të tjerëve për ndonji inisiativë që kishin dëshirë të merrshin, kur bajshin ndonji veprim të ndaluem etj. Po apim ma poshtë disa fragmente të regjistrueme në këto ambiente: **Idh'e shug-quki op dhrib em parv** (erdhi gushëkuqi: xhandari, po bridh me vrap). **Op njev ero, ët iruz op ki em parv** (po vjen ore, te zuri, po ik me vrap — kur futeshin nepër bahçe të botës). **Raç ramadi ët-she yk um is on enj soll** (Çar damari është ky mu si nonjë llos). **Uk ej ero? Kun ët mak rap iç eraf** (Ku je ore, nuk të kam parë iç fare). **Uk ek neq?** (Ku ke qenë). Nu adhre ën ipëtsh rep ët rutjav en anemik, op

21) Asht marrë rreth vitit 1934 nga nxanës të shkollës Normale të Elbasanit.

kun et tégja etjá. (Unë erdha në shtëpi, për të vajtur në kinema, po nuk të gjeta atje.) **Od shiv em aúm etn's ën amenik?** (Do të vish me mua sonte në kinema). **Oj, kun iv tod, es mak mikat.** (Jo nuk vi dot se kam takim). Në një familje kishin kthye së prapthi lodrën e njoftun: Tri sopatha plaka/ presin tre plepa pleq./ plepi më plak./ ka pals me pak: **Irt opatós akálp, nisérp ert apélp qelp/, ipelp ëm kalp,/ ak slap ëm kap.** Dhe këto i thojshin përmendsh me shumë shpejtësi në formë lodre.

Me qëllim që biseda të dali ma e rrjedhëshme nuk bajnë një spostim të rregullt të germave të çdo fjale. Në ndonji rast i ngatrollojnë vendet e germave edhe për të mos u kuptue kollaj prej të tjerëve. Kështu fjalët lulishte, atje, bardhak kthehen: **ititshul, etjá, dhrakab.** Po për një qëllim të tillë — për t'u ba të pakuptueshëm -mbi këte bazë, mbi fjalët e kthyesme së prapthi, shtojmë edhe rrokje argotike me f, s etj. **Afod ëfët jofoksh ëfëm afamefenifik.** (Do të shkoj në kinema).

Të rrijtë që e kanë bamë shprehë të folunit në kët mënyrë, i apin edhe ngjyra të ndryshme tue i theksue fjalët në fillim, në mest ose në fund, kështu që të duket sikur flasin ungarisht, çobançe, arixhisht, etj.

Në këto kohët e fundit të folme të tilla janë tue u futë edhe në rrethet e studentëve universitarë. Më ka ndodhë të ndëgjoj në Institutin e Lartë të Arteve Figurative dy studentë të bisedojnë rreth një modeli që kishin përpara: **A. Ishë enj kiç etëk rubin raç ekok ëq ak, raç mrofash ekistapl!** (Shihe një çikë këte burrin çar koke që ka, çar formash plastike). **B. I rim tshë op aum ëm kudet es akok tshë kap e dhame ën mihasark em nipurt.** (I mirë është, po mua më duket se koka është pak e madhe në krahasim me trupin). **A. Yk tshë pit ilorasam! Raç shetasqum ëqak, ët azez e ët atrjed rukis aj ak rerp irenj em ërshërg!** (Ky është tip malsori! Çar mustaqesh që ka, të zeza e të drejta sikur ja ka prerë njeri me gërshërë!). **B. E mel itshat nupën es iledom u tizëm mush.** (E lemë tashti punën se modeli u mërzi shumë).

Studentët këthejnë fjalë të gjata e të vështira, të cilat i përsërisin shumëherë për të stërvitë gjuhën me këto lloj të folme: **Imzilanoican-rein ra telorp** (Internacionalizmi proletar), **Itetlukáfi Sigjoloíif** (Fakulteti i Filologjisë), **Itetlukáfi Evacneksh të Sërytán** (Fakulteti i Shkencave të Natyrës), **Itetlukáfi Siskéjm** (Fakulteti i Mjeksisë), **Itarotker** (Rektorati).

Në të folmet e grupit të dytë — në të folmet që kanë një fond leksikor të veçantë, me një aftësi komunikuese të pavarun — do të trajtohen radhazi: dogançja e lovidharçja purishtja e çorkishtja, dalipbebcja. Në një kapitull të fundit do të epen disa elementë nga të folmet e zejtarve shetitës të pakicave kombëtare që rrojnë në territorin e atdheut tonë: të së folmes së muratorëve të Gollobordës, të së folmes **alifiatika** të kallajxhijve të katundeve Karroq, Grazhdan, Zminec, Malçan dhe ndonjë element nga sopiqotçja e bucelapunuesve të Sopikut.

R é s u m é

LES LANGAGES SOCIAUX DE L'ALBANAIS

En albanais, à côté des dialectes territoriaux, vivent aussi un certain nombre de langages conventionnels: argot, baragouin, jargon, patois, utilisés par les divers milieux sociaux (artisans, étudiants, etc.). Dans le but de les différencier des dialectes territoriaux, l'auteur a employé le terme langages sociaux, il s'agit en effet de langages particuliers propres à communiquer les projets sans être compris par l'entourage.

Haxhihasani considère comme tendances de différenciation des langages conventionnels de la langue commune, les nuances stylistiques de la conversation (ironie, allégorie), les épithètes, les synonymes. Comme une phase avancée de cette différenciation, il signale l'usage des gestes et des signes faits avec les mains, les lèvres, la tête, etc., quand on veut communiquer une pensée, un désir ou un besoin, dont on ne veut pas qu'on le sache un tiers.

Dans quelques régions, comme à Tirana, on fait usage de vocables et d'expressions mutilés qu'on emprunte au langage de la minorité aroumaine: on a ainsi l'argot. Dans les cercles artistiques on fait usage de vocables empruntés au langage des tsiganes: une sorte de jargon.

Un facteur fondamental dans la naissance et l'évolution de ces langages reste toujours le besoin de communiquer par un groupe d'hommes ayant des intérêts communs, sans se faire comprendre par le milieu environnant.

La place principale de nos langages sociaux va à ceux des artisans ambulants: la dogançe = l'argot des étameurs de Maleshove, des chirurgiens empiriques de Bual, des scieurs de long de la Rrëzë (arrondissement de Permet et de Leskovik); la purishtë = l'argot des maçons d'Opar (Korçe); la dalipbebeçe = le patois des journaliers de la Malessie de Tirane.

Les argots des artisans sont appelés par la population aussi: parler de débine, parler imposé par le besoin. Ils sont employés par des groupes isolés d'artisans, quand ils font des immigrations loin de leurs pays d'origine, et cela pour surmonter les difficultés de la vie, s'assurer un abri, s'entendre pour le travail, etc. Dans cet article sont donnés plusieurs exemples des circonstances où l'on emploie l'argot dogançe par les étameurs ambulants de Permet.

L'argot de profession est enseigné aux jeunes pendant le travail. Au commencement, les jeunes sont familiarisés avec les mots les plus communs: noms de choses, etc., puis ils passent aussi aux concepts abstraits. Ces derniers ne sont assimilés que par voie orale, une raison celle-ci pourquoi la structure et l'ampleur de leur glossaire ne sont pas aussi bien stabilisées.

Des données attestant l'ancienneté de nos langages conventionnels n'existent pas, malheureusement. Quoi qu'il en soit, d'après quelques signalations indirectes, ces langages doivent avoir été utilisés chez nous, au moins depuis la fin du XVIIIe siècle.

Haxhihasani divise ces langages en deux grands groupements: 1) langages qui se basent sur le changement mécanique du lexique de la langue commune (jargon et baragouin); 2) langages qui ont créé un système lexical offrant des facultés indépendantes d'expression (argot, patois).

Dans les langages du premier groupe, les mots de la langue commune ne subissent aucun changement de sens. Ils deviennent incompréhensibles par un arrangement bizarre, une prononciation défectueuse, sa prolongation au moyen d'une ou de plusieurs syllabes, par le déplacement de celles-ci ou l'anagramme.

Le lexique des langages du deuxième groupe est alimenté par deux sources importantes: le lexique de la langue maternelle et celui des langues étrangères vivant dans des îlots minoritaires à l'intérieur des frontières politiques du pays ou dans ses environs immédiats. Ces genres de langages ont emprunté plusieurs mots à la langue commune, auxquels ils n'ont fait que changer le sens. Comme exemples nous citerons: djegie = qepa (oignon), rrjedhje = krue (fontaine), erëz = hundë (nez), etc. Haxhihasani porte également des exemples d'archaïsme de mots dialectaux, de noms propres, de toponymes, etc., sur la base desquels on a créé des mots du lexique de nos langages conventionnels.

Au point de vue des catégories grammaticales, le vocabulaire de nos langages conventionnels est formé par les noms, les adjectifs et les verbes. Les adverbes et les nombres sont insignifiants. Les autres parties du discours sont directement empruntées à la langue commune. Dans la construction du mot on emploie toujours des affixes et les schémas de la formation des mots de cette langue. Haxhihasani donne des exemples de telles formations à l'aide de préfixes suffixes et de composés. Il analyse en même temps les formations sémantiques — les modes par lesquels on attribue aux mots leur sens: à l'aide de métaphores exprimées au point de vue de la forme par un nom, un adjectif ou un participe et qui se rattachent, au point de vue du sens, à une qualité expressive de l'objet, qualité qui peut appartenir au domaine de la vue, de l'acoustique, du goût, etc. Le tout est illustré par des exemples.

Pour ce qui est de l'enrichissement du vocabulaire des langages conventionnels à l'aide d'emprunts étrangers, Haxhihasani fait observer qu'il s'agit de langue limitrophes: le grec et le slave. D'autres langues qui ont contribué en ce sens sont l'aroumain, le turc et le tsigane.

Haxhihasani examine aussi l'utilisation du système phonétique, morphologique et syntactique de la langue commune par les langages conventionnels: comment se reflètent dans ceux-ci les particularités phonétiques des dialectes territoriaux, comment est formé le pluriel, le genre féminin du masculin ou viceversa, comment est faite la conjugaison des verbes, comment correspond parfaitement au système syntactique de la langue commune le mode de construction des phrases, leur rangement et leur coordination.

Dans le dernier chapitre, Haxhihasani traite des questions les langages du premier groupe (de ceux qui ont pour base de commu-

nication la langue commune, transformée à l'aide de moyens d'alternation extérieure). Ceux-ci vivent dans plusieurs régions du pays, dans des villes et des villages. Ils sont employés principalement dans les milieux familiers et estudiantins. La forme la plus simple de leur construction est celle d'ajouter au mot une syllabe argotique à la fin ou au milieu du mot. Dans l'article sont traités tous les modes de combinaison de ce genre de particules dans notre pays.

Dans les milieux estudiantins on emploie le renversement du mot

Le tout est illustré par différents matériaux (extraits de discours, correspondance entre jeunes, etc.) qui permettent de saisir au vif ces discours et ces combinaisons.